

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5563  
E enjte, 30 gusht 2018  
çmimi 0.40 €

## Protestuesit të vendosur në kërkesën për shkarkimin e Lumezit

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE" ANËTARI I KRYESISË  
SË NISMËS, FAZLI HOXHA ■ FAQE 4-5

## Për temat kombëtare duhet konsensus i gjerë

Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Fazli Hoxha, ka thënë se ky subjekt politik po tregon përgjegjësi në qeverisjen aktuale në vend me ministrinë që drejton dhe në qeverisje në nivelin lokal. Ai ka thënë se Nisma do t'i mbajë premtimet për realizimin e projekteve si ai "çdo familje nga një të punësuar". Duke folur për fazën e fundit të dialogut Kosovë - Serbi, Hoxha ka theksuar se lideri i par-

tisë së tij, Fatmir Limaj, disa herë u ka bërë thirrje të gjitha forcave politike mos t'i ikën kësaj përgjegjësie në këtë proces. "Për temat kombëtare duhet të gjendet konsensus sa më i gjerë", është shprehur ai. Hoxha ka folur edhe për qeverisjen në Gjakovë, ku pjesë e saj është edhe Nisma. Sipas tij, shumica e projekteve që ky subjekt ka prezantuar gjatë fushatës zgjedhore tashmë janë duke u zbatuar



### AKTUALE

Z. BLAKAJ LËSHOI  
MUNDËSINË TË  
JETË HERO I  
GJALLË I KOSOVËS  
SË PASLUFTËS F. 11



Ylber ÇITAKU

HOXHA PRET VOTIM POZITIV  
PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE  
NË KOMITETIN LIBE F. 2

AMBASADORI DELAWIE  
NDEROHET ME 'HARTËN E  
ARTË TË KOSOVËS' F. 8

POLICIA ARRESTON 17 TË  
DYSHUAR PËR PËRFSHIRJE  
NË VEPRIMTARI PENALE F. 8

## Thaçi: Opozita po e vë në pikëpyetje përkrahjen ndërkombëtare

FAQE 3



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kritikuar opozitën se po e vë në pikëpyetje përkrahjen e fuqishme të bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën në procesin e dialogut me Serbinë. Ndërsa opozita më 4 shtator po synon t'i ndër-

presë synimet e presidentit Thaçi, në bisedimet me homologun e vet serb, duke thirrur një seancë të jashtëzakonshme parlamentare për të diskutuar rreth idesë së presidentit për korigjimin e kufirit Kosovë - Serbi



Dialogu të  
kushtëzohet  
me  
ndriçimin  
e fatit të  
personave  
të zhdukur

### EKONOMI

AGJENDA EKONOMIKE  
SFIDOHET NGA POLITIKA  
DITORE F. 8

### KULTURË

162 VJET KUNDËR  
SHQIPTARËVE,  
RUSOMADHJA F.13



RECENSION PËR DY  
LIBRA TË POETIT  
FEHMI PIREVA F.13



Salihe SALIHU -  
PhD dhe veprimtare

### SPORT

UEFA MBËSHTET  
FINANCIARISHT NDËRTIMIN E  
TRI FUSHAVE NË OBILIQ F. 18

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Rama nuk bën ndryshime në Qeveri

**TIRANË, 29 GUSHT** - Të gjithë prisnin, edhe në PS, që kryeministri Edi Rama të bëjë ndryshime në qeveri, por do të zhgënjehen. Burime shumë të afërta pranë Edi Ramës thonë se kishte një ide për ndërrim ministrash, por tani ka vendosur të mos bëjë asnjë ndryshim. Dhe do ta motivojë me argumentin se

Qeveria nuk ka as edhe një vit në detyrë, si dhe për të mos dhënë argument opozitës, e cila do të turret "se ka dështuar qeverisja prandaj u mundua të bëjë amime", Edi Rama e ka ndarë mendjen për të mos bërë asnjë lëvizje në qeveri. Në raport me zgjedhjet vendore në maj 2019, atëherë ai do të shikojë

mundësinë e ndryshimit të ministrave. Edhe në mbledhjen e Asamblesë së PS-së, pas ditësh, kryeministri dhe kryetari i PS-së do të justifikojë se nuk ka nevojë për ndryshime kur gjithçka, sipas tij, ecën mirë.

I njëjti burim tha se ka edhe një mundësi se përse ai nuk bën

ndryshime, sepse dy ministra të rëndësishëm nuk pranojnë të japin dorëheqjen apo t'i shkarkojë. Ndaj mundet për të treguar se mbetet fuqiptotë në PS, Rama do të veprojë me finesë duke thënë se qeverisja ka ecur shumë mirë, ndonëse do të duhet t'i rregullojmë disa gjëra.



# Hoxha pret votim pozitiv për liberalizimin e vizave në Komitetin LIBE

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, po qëndron në Bruksel, ku po mbahet takimi i Komitetit për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, i njohur si LIBE. Ajo pret që sot (e enjte) Komisioni LIBE të votojë pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës



**BRUKSEL, 29 GUSHT (ER)** - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, po qëndron në Bruksel, ku po mbahet takimi i Komitetit për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, i njohur si LIBE. Në këtë takim të mërkurë është diskutuar çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën, ndërkaq sot (e enjte) pritet të votohet.

Gjatë qëndrimit në Bruksel, ministrja Hoxha është takuar me eurodeputetën nga Sllovenia, Tanja Fajon, anëtare e Aleancës Progresive të Socialistëve dhe Demokratëve, si dhe raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian. "Në takim ministrja Hoxha ka vënë në dukje përbushjen e të gjitha kushteve për liberalizim nga udhërrëfyesi si dhe

pritet për vendimet pozitive për liberalizimin e vizave, sidomos pritet që Komisioni LIBE të votojë sot (e enjte) pro liberalizimit", është theksuar në komunikatën e Ministrisë së Integrimit Evropian. "Fajon ishte me vite një përcjellëse besnike e të arriturve dhe intereseve të Kosovës. Edhe tash mirëpresim kontributin e saj si raportuese në Parlamentin Evropian, duke rikonfirmuar të arriturat tona për liberalizimin e vizave, procesin integruës dhe lobimin për njohjen e shtetit dhe shtetësisë sonë në organizatat ndërkombëtare", ka thënë ministrja Hoxha.

Eurodeputetja dhe raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, sipas komunikatës, ka

pohuar se është e lumtur që po rikonfirmohen të arriturat e Kosovës, se qytetarët e Kosovës do ta gëzojnë lëvizjen e lirë ashtu si krejt qytetarët e tjerë të Evropës. Fajon ka thënë se puna më e madhe mbetet për t'u bërë, që pro-

cesi integruës të vijojë me hapa edhe më të shpejtë, duke zbatuar reformat në drejtësi, në ekonomi dhe të tjera, si dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Ministrja Hoxha ka takuar në Bruksel edhe eurodeputetët Marie

Christine Vergat, Angelika Mlinar dhe eurodeputetën Asim Ademov, të gjithë anëtarë të Komisionit LIBE, nga të cilët thuhet se është rikonfirmuar mbështetja për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

## Meta: Shqiptarët e Maqedonisë të votojnë pro referendumit



**TIRANË, 29 GUSHT** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta thekson në mënyrë të veçantë se duhet që shqiptarët e Maqedonisë të marrin pjesë masivisht në referendumin e datës 30 shtator si dhe të votojnë pro marrëveshjes. "Më 30 shtator Qeveria Zaev do të organizojë referendumin lidhur me marrëveshjen e arritur me Greqinë për emrin e ardhshëm të saj, rezultati i të cilit është ende një dilemë. Sa i rëndësishëm është për Shqipërinë

e rajonin ky rezultat? Integrimi i rajonit në BE dhe në NATO është një proces i rëndësishëm dhe jetik për të ardhmen e tij. Maqedonia ndodhet në një moment shumë të rëndësishëm, të favorshëm dhe optimist, pas një periudhe të gjatë stanjacioni në marrëdhëniet me Greqinë, me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n", tha Meta. "Pa asnjë mëdyshje ne kemi mbështetur dhe nxitur dialogun e drejtpërdrejtë mes Athinës e Shkupit me

bindje të plotë se kjo është rruga më e mirë për të çuar përpara dhe për të gjetur zgjidhjen e duhur të procesit të tejzgjatur integruës të Maqedonisë.

Marrëveshja e arritur me Greqinë për emrin hap një perspektivë të re, është një hap pozitiv i Maqedonisë drejt anëtarësimit të saj në NATO, integritet në BE dhe ndikon drejtpërdrejt në paqen, sigurinë dhe stabilitetin e rajonit tonë", ka thënë Meta.

## Bashkimi Evropian kyçet në fushatën e referendumit në Maqedoni

**SHKUP, 29 GUSHT** - Zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian janë përfshirë në fushatën për referendumin e 30 shtatorit, në të cilën qytetarët duhet të deklarohen për Marrëveshjen me Greqinë për zgjidhjen e problemit me emrin e shtetit. Drejtori i Drejtorisë për Zgjerim në

Komisionin Evropian, Kristijan Danielson, kamarrë pjesë në Shkup në hapjen e takimeve me qytetarë dhe përfaqësues të fushave të ndryshme, për t'i inkurajuar votuesit që të marrin pjesë në referendum dhe të votojnë për të ardhmen evropiane të Maqedonisë. "Më 30

shtator qytetarët këtu do të bëjnë zgjedhjen e generatave që t'i japë formë të ardhmes së këtij vendi. Do të ketë pasoja për generatat e ardhshme. Mendoj se apeli ynë për secilin është që të ushtrojë të drejtën demokratike duke rrethuar në fletëvotim. Është një mundësi unike

t'i jepni formë shoqërisë, në të cilën ju dëshironi të jetoni dhe t'i shihni familjet tuaja duke përparuar", ka deklaruar Danielson.

Ambasadori i Bashkimit Evropian, Samuel Zhbogar, tha se marrëveshja me Greqinë aspak nuk cenon identitetin dhe gjuhën maqedonase përkundrazi, sipas tij, me këtë dokument maqedonishtja do të jetë gjuhë zyrtare e BE-së.



donase përkundrazi, sipas tij, me këtë dokument maqedonishtja do të jetë gjuhë zyrtare e BE-së.

Presidenti Hashim Thaçi i është përgjigjur opozitës, e cila ka kërkuar seancë të jashtëzakonshme për idenë e korrigjimit të kufirit Kosovë - Serbi

# Thaçi: Opozita po e vë në pikëpyetje përkrahjen ndërkombëtare



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kritikuar opozitën se po e vë në pikëpyetje përkrahjen e fuqishme të bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën në procesin e dialogut me Serbinë. Ndërsa opozita më 4 shtator po synon t'i ndërpresë synimet e presidentit Thaçi, në bisedimet me homologun e vet serb, duke thirrur një seancë të jashtëzakonshme parlamentare për të diskutuar rreth idesë së presidentit për korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 GUSHT - Një ditë pasi opozita ka kërkuar seancë të jashtëzakonshme parlamentare për të diskutuar rreth propozimit të presidentit për korrigjim të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, shefi i shtetit ka akuzuar partitë opozitare për propagandë të paskrupullt kundër aleatëve ndërkombëtarë. Në profilin e vet në "Facebook", Thaçi ka shkruar se nuk ka fatkeqësi më të madhe për shtetin dhe qytetarët e Kosovës kur disa parti opozitare apo individë e vendosin në pikëpyetje përkrahjen e ShBA-së dhe të aleatëve tanë kryesorë. "Që nga shpallja e pavarësisë dhe deri më sot, Kosova asnjëherë nuk ka pasur vëmendje më të madhe ndërkombëtare. Duke filluar nga ShBA-ja, Gjermania, Franca,

Italia, Anglia dhe pothuajse të gjitha shtetet anëtare të BE-së, janë të përfshira në përpjekjet për arritjen e marrëveshjes paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje eventuale, e cila është shumë e vështirë të arrihet, qëllim kryesor ka njohjen e Kosovës nga Serbia dhe anëtarësimin tonë në BE, NATO dhe OKB. Pra, përderisa në njërin anë kemi të gjithë aleatët e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës në mbështetje të fuqishme për arritjen e marrëveshjes paqësore me Serbinë, fatkeqësisht në Kosovë, në anën tjetër kemi një opozitë të ndihmuar nga disa zëra të vetmuar të shoqërisë civile që e konsiderojnë këtë mbështetje si qëllimkeqe për Kosovën", ka shkruar Thaçi. Sipas tij, kjo propagandë e opozitës ndaj bashkësisë ndërkombëtare është e rrezikshme për Kosovën. "Nuk

ka fatkeqësi më të madhe për shtetin dhe qytetarët e Kosovës kur disa parti opozitare apo individë e vendosin në pikëpyetje përkrahjen e ShBA-së dhe aleatëve tanë kryesorë. Kjo situatë është për keqardhje. Sovraniteti shtetëror dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës janë të garantuar nga Kushtetuta jonë, dhe jo nga deklaratat emocionale të atyre që as nuk e kanë idenë se si janë fituar liria dhe pavarësia jonë. Kjo propagandë e paskrupullt e partive opozitare kundër aleatëve tanë ndërkombëtarë, e mbështjellë me panikun për, kinse, cenimin e sovranitetit shtetëror, është e rrezikshme dhe e turpshme", ka shkruar ai, duke shtuar se kurrë asnjë e keqe nuk i vjen Kosovës nga mbështetja e aleatëve tanë perëndimorë. "E vetmja e keqe që mund t'i vijë vendit tonë është vetëm nga ata që nuk duan marrëveshje paqësore me Serbinë, që nuk duan anëtarësim të Kosovës në BE, NATO dhe OKB. Qytetarët tanë duhet ta bëjnë zgjedhjen e tyre nëpërmjet referendumit. Ata duhet të zgjedhin se a janë për marrëveshje paqësore me Serbinë, e cila Kosovës i siguron anëtarësim në BE, NATO dhe OKB, apo duan të jetojnë në hasmëri me shtetet fqinje dhe të izoluar. Unë e di se ata do të

zgjedhin opsionin e parë, prandaj edhe po punoj në koordinim të ngushtë me aleatët tanë ndërkombëtarë, që paqja me fqinjë dhe integrimi të jenë zgjedhja e duhur", ka vlerësuar Thaçi. Edhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, e ka siguruar opozitën se nuk do të ketë cenim të sovranitetit dhe integritetit të Kosovës. Iniciativën e opozitës për të thirrur seancë të jashtëzakonshme për këtë çështje e ka konsideruar si të vonuar. "Mua më vjen keq se Kuvendi vërtet po ecën pas proceseve. Ka shumë kohë që ia kam dhënë këtë mundësi Kuvendit, pikërisht këtë që po duan ta bëjnë tash me rezolutë, ka muaj të tërë që kam shkruar në Kuvend dhe kam kërkuar të marrin përgjegjësi, të marrin qëndrim. Kjo marrëveshje nuk bën ta përfshijë prishjen e sovranitetit dhe integritetit territorial apo lëvizjen e kufijve të Kosovës. Besoj se për këto dy tema pajtohemi të gjithë në Kosovë. Si kryeministër, por edhe si Aleancë, do t'i japim mbështetje ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial", ka thënë Haradinaj. Ditë më parë edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka bërë me dije se Kosova do ta mbrojë integritetin territorial dhe nuk do të ketë ndarje apo shkëmbim të territoreve. "Qëndrimi i Kosovës është

## Opozita kërkon ta ndalë idenë e presidentit

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka dorëzuar të mërkurën kërkesën për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit, e cila do të ketë vetëm një pikë të rendit të ditës. Ndonëse kjo seancë nuk është thirrur ende zyrtarisht nga Kryesia e Kuvendit, Hoti ka treguar se me ndihmën e subjekteve të tjera opozitare i ka marrë nënshkrimet e nevojshme të deputetëve për ta thirrur caktimin e seancës. Opozita synon që në këtë seancë ta propozojë nxjerrjen e një rezolute përmes së cilës do të kërkohej t'i ndalohej presidentit të negociojë për tërësinë territoriale të Kosovës. "Duke parë gatishmërinë e shumicës së grupeve parlamentare për ta mbështetur këtë qëndrim, rezoluta do të aprovohet me mbi 80 vota. Nuk ka mekanizëm politik më të fuqishëm për ta shprehur vullnetin e qytetarëve të Kosovës përmes deputetëve të Kuvendit të Kosovës si të zgjedhur të qytetarëve", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, askush nuk duhet të ketë guxim të ndërmarrë hapa që bien në kundërshtim me vullnetin e shumicës dërrmuese të deputetëve në Kuvendin e Kosovës. "Rezoluta e Kuvendit të Kosovës është e obligueshme për të gjithë. Nëse dikush vepron ndryshe, atëherë bie ndesh me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe pasojat kushtetuese dhe politike janë të ditura. Kjo rezolutë do të dërgojë te miqtë tanë ndërkombëtarë, që kanë ndihmuar shtetin e Kosovës, të arrijë në këtë pikë ku është tani, vullnetin e qartë të qytetarëve të Kosovës, se nuk janë të gatshëm të negociojnë për territorin e Republikës së Kosovës", ka shkruar Hoti.

shumë i qartë, njohja e shtetit të Kosovës si shtet sovran nga Serbia, ulësja në organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe për këtë as nuk ka dilema. Ne jemi të vendosur të ecim në procesin e paqes, procesin e komunikimit dhe të integritetit euroatlantik si shtet i pavarur dhe sovran", ka thënë Veseli.

Flet për "Epokën e re" anëtari i Kryesisë së Nismës, Fazli Hoxha

# Për temat kombëtare d



Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Fazli Hoxha, ka thënë se ky subjekt politik po tregon përgjegjësi në qeverisjen aktuale në vend me ministrinë që drejton dhe në qeverisje në nivelin lokal. Ai ka thënë se Nisma do t'i mbajë premtimet për realizimin e projekteve si ai "çdo familje nga një të punësuar". Duke folur për fazën e fundit të dialogut Kosovë - Serbi, Hoxha ka theksuar se lideri i partisë së tij, Fatmir Limaj, disa herë u ka bërë thirrje të gjitha forcave politike mos t'i ikin kësaj përgjegjësie në këtë proces. "Për temat kombëtare duhet të gjendet konsensus sa më i gjerë", është shprehur ai. Hoxha ka folur edhe për qeverisjen në Gjakovë, ku pjesë e saj është edhe Nisma. Sipas tij, shumica e projekteve që ky subjekt ka prezantuar gjatë fushatës zgjedhore tashmë janë duke u zbatuar

Politikën Sociale 2018-2022 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2018-2020 për zbatimin e strategjisë. Këto dokumente nuk janë vetëm dokumente që do të mbesin në letër, por do të zbatohen në përpikëri.

**"Epoka e re":** Në kuadër të fushatës zgjedhore Nisma ka prezantuar projektin në çdo familje nga një të punësuar. Edhe tani në kuadër të MPMS-së po e proklamoni këtë projekt. Sa është duke u realizuar në praktikë ky projekt?

**Hoxha:** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale angazhohet për rritje të mirëqenies nëpërmjet ofrimit të mundësisë për punësim. Projekti i ofruar nga Nisma Socialdemokrate për punësimin e një anëtari të secilës familje, përfutjesit e asis-

tencës sociale të cilët nuk kanë asnjë të punësuar dhe që kanë të paktën një anëtar të familjes të aftë për punë (kategoria e dytë e skemës së ndihmave sociale), është pjesë e programit të Nismës Socialdemokrate dhe e përkrahur fuqishëm nga Qeveria e Kosovës. Anëtarët e këtyre familjeve të cilët nuk janë të përgatitur profesionalisht vazhdojnë t'i vizitojnë Qendrat e Aftësimit Profesional, që të trajnohen në një mori profilesh. Gjithashtu, bizneset janë duke vizituar zyrtarë e punësimit dhe Qendrat e Aftësimit Profesional, dhe aty po gjejnë fuqinë punëtore që u nevojitet. Të gjithë ata të cilët janë të përgatitur profesionalisht ne po bëjmë përpjekje t'i bëjmë pjesë të masave aktive të tregut të punës. Në kuadër të kësaj ne kemi mar-

**EPOKA E RE**

**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 GUSHT -

**"Epoka e re":** Z. Hoxha, ju jeni këshilltar politik i ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, si ishte gjendja në këtë ministri?

**Hoxha:** Menjëherë pas pranimit të detyrës ministri Skender Reçica ka vendosur të bëhet

incizimi i gjendjes aktuale në ministri. Pas një pune intensive dhe ekipore, në koordinim edhe me stafin civil në MPMS, kemi bërë identifikimin e temave të cilat kërkojnë zgjidhje dhe vendimet të cilat duhet të miratohen nga Qeveria për ta ndryshuar gjendjen në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**"Epoka e re":** Cilat janë ato vendime më të rëndësishme që janë miratuar në Qeveri me propozim të ministrit?

**Hoxha:** Është punuar në të gjitha fushat që janë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në Qeveri janë miratuar dokumente të rëndësishme si Strategjia Sektoriale për Punësimin dhe

# uhet konsensus i gjerë

**"Epoka e re":** Ju jeni anëtar i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate dhe kryetar dege në Gjakovë. Cili është mendimi juaj për fazën e fundit të dialogut Kosovë - Serbi?

**Hoxha:** Faza finale e dialogut Kosovë - Serbi do të jetë një proces jo edhe aq i lehtë, duke marrë parasysh se në këtë proces synohet arritja e një marrëveshje përfundimtare rreth normalizimit të raporteve ndërmjet dy shteteve. Mendojmë se është e domosdoshme barasvlerësimi në nivelin institucional dhe barasvlerësimi në nivelin profesional, atë të përfaqësimit të ekspertëve që do duhej të jenë të angazhuar në këtë proces dialogues. Aspekti legal i arritjeve dialoguese në këtë proces gjithsesi duhet të konfirmohet nga pozicionet institucionale demokratike dhe normativave shtetërore. Ne si Nismë Socialdemokrate besojmë se për të pasur sukses dialogu duhet gjithëpërfshirje dhe konsensus kombëtar. Z. Limaj si lider partie dhe si zëvendëskryeministër u ka bërë thirrje të gjitha forcave politike që mos t'i ikin kësaj përgjegjësie. Për temat kombëtare duhet të gjendet konsensus sa më i gjerë.

**"Epoka e re":** Çfarë shtirrje të Nismës keni në Gjakovë?

**Hoxha:** Nisma në Gjakovë tani është e shtrirë në të gjithë territorin e kësaj komune. Në muajin prill të këtij viti kemi mbajtur Kuvendin e Përgjithshëm të Punës në Degë, ku janë mbajtur kuvendet nga nëndega, Kuvendi i Rinisë, i Gruas dhe Kuvendi i Përgjithshëm i Degës. Nga ky kuvend kanë dalë 42 nëndegë dhe strukturat drejtuese të degës.

**"Epoka e re":** Në Degën e Nismës në Gjakovë në vazhdimësi ka aderime. Dega e AKR-së në Gjakovë ka kaluar te Nisma?

**Hoxha:** Vazhdimisht Degës së Nismës në Gjakovë i janë bashkuar anëtarë nga të gjitha partitë politike dhe qytetarë që më parë nuk ishin të inkuadruar në politikë. Disa muaj më parë është bashkuar edhe kryetari i degës së AKR-së, Edmind Dushi, i cili është edhe këshilltar në Asamblenë Komunale në Gjakovë. Ai i është bashkuar Nismës me të gjitha strukturat e Degës së AKR-së. Gjithashtu, kemi shumë personalitete të respektuar në Gjakovë që kanë aderuar në Nisma Socialdemokrate. Subjekti ynë politik ofron mundësi për të gjithë qytetarët për ta dhënë kontributin e tyre politik në të

mirë të zhvillimit të shtetit. Sot Nisma Socialdemokrate në Gjakovë është forca e tretë politike. Besojmë se kjo besueshmëri e qytetarëve të rritet në vazhdimësi në të ardhmen, sepse Nisma Socialdemokrate nga fillimi i saj ka proklamuar një politikë e cila bashkon njerëzit. Po të shohim sot Nisma në nivel vendi është subjekt politik që ka përgjegjësi në qeverisje në nivel qendror dhe lokal. Nisma po ecën me hapa të sigurt drejt rritjes si forcë politike. Fuqia e saj politike do të shihet në zgjedhjet e ardhshme.

**"Epoka e re":** Nisma në Gjakovë është në bashkëqeverisje me AAK-në. Si po shkon bashkëqeverisja?

**Hoxha:** Në zgjedhjet lokale ne garuam si parti e vetme me kandidatit për kryetar të komunës dhe kandidatët për këshilltarë komunalë. Arritëm rezultat të kënaqshëm në balotazh për kryetar të komunës, pastaj marrëveshje politike me AAK-në për bashkëqeverisje në këtë mandat katërvjeçar. Nisma në asamble përfaqësohet me tre këshilltarë komunalë, një drejtor, si dhe përfaqësim në pozita të tjera në Komunën e Gjakovës.

**"Epoka e re":** A po gjen vend për realizim programi të cilin ju e keni prezantuar gjatë zgjedhjeve lokale në Gjakovë?

**Hoxha:** Pas pranimit të detyrës, kryetari i komunës, z. Adrian

Gjini, ka mbajtur takim me të gjitha partitë fituese në koalicion. Pjesë të programit politik janë fuzionuar në programin komunal për katër vjetet e ardhshëm. Tani është bërë miratimi i kornizës afatmesme 2019-2021. Në këtë kornizë janë miratuar shumica e projekteve të Nismës Socialdemokrate në Gjakovë. Kanë mbetur disa projekte pa u përfshirë në këtë kornizë, siç është asfaltimi i rrugës për në Sukë të Cërmjanit, ku në atë vend janë xhamia dhe tyrbja që vizitohen nga qytetarë anekënd Kosovës. Megjithatë, besojmë se me miratimin e buxhetit ky projekt do të gjejë vend në mënyrë që të realizohet pasi ka një rëndësi të veçantë për qytetarët.

## Ambasadori Delawie nderohet me 'Hartën e Artë të Kosovës'



**PRISHTINË, 29 GUSHT (ER)** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka prituri të mërkurën në takim falënderues ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, me të cilin ka biseduar për gjendjen politike në Kosovë dhe më gjerë.

Gjatë takimit kryeministri ka falënderuar ambasadorin Delawie për angazhimin dhe kontributin e tij të madh dhënë gjatë shërbimit të tij në Kosovë, duke thënë se Kosova dhe populli i saj janë mirënjohës për mbështetjen e ShBA-së në të gjitha fushat, duke e ndihmuar vendin në proceset e rëndësishme politike, ekonomike dhe të sigurisë. "Në shumë fusha

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ndihmuar Kosovën, duke përfshirë shtetndërtimin, zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë, sistemin e drejtësisë, bujqësinë dhe për këtë u jemi mirënjohës popullit amerikan dhe ShBA-së", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj, në takim me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie.

Kryeministri Haradinaj ka deklaruar se partneriteti strategjik ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të vazhdojë të thellohet, duke kërkuar mbështetjen e mëtutjeshme të shtetit mik për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

Kryeministri Haradinaj, në shenjë respekti për kontributin e dhënë gjatë misionit në Kosovë, ia ka dhuruar ambasadorit Delawie "Hartën e Artë të Kosovës". "Është nder që në emrin tim, të Qeverisë dhe të popullit të Republikës së Kosovës, t'ju dorëzoj 'Hartën e Artë të Kosovës', të cilën kam kënaqësinë t'ju dhuroj për shërbimin tuaj në shtetin tonë", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ndërkaq ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për bashkëpunimin, duke shprehur gatishmërinë e ShBA-së që ta vazhdojë mbështetjen edhe më tutje për Kosovën për forcimin e sundimit të ligjit.

rëveshje bashkëpunimi me partnerët tanë, si: GIZ, UNDP, pastaj vizitat e shumta të ministrit Reçica, organizimi i panairëve të ndryshme të punës që kanë këtë qëllim etj. Zëvendëskryeministri Limaj, ministri Reçica dhe bartës të drejtpërdrejtë të angazhimeve nga niveli i departamenteve të MPMS-së, në bashkëpunim me drejtoritë për mirëqenie sociale nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, kanë zhvilluar takime të shumta me përfituesit e asistencës sociale - kategoria e dytë me qëllim informimin dhe orientimin përkatës lidhur me përfshirjen dhe zbatueshmërinë në kuadër të realizimit të projektit "Një i punësuar nga ato familje që nuk kanë asnjë të punësuar dhe që kanë së paku një anëtar të aftë për punë".

# Protestuesit të vendosur në kërkesën për shkarkimin e Lumezit



Qytetarë të shumtë, përfaqësues të shoqërisë civile, edhe aktivistë të partive opozitare, janë mbledhur të mërkurën në Sheshin "Zahir Pajaziti", në protestën e dytë për ta kërkuar dorëheqjen e kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, si dhe duke kërkuar veting për sistemin e drejtësisë

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 GUSHT - Qytetarë të shumtë janë mbledhur sërish të mërkurën në qendër të Prishtinës dhe kanë marshuar së pari deri para zyrës së krye-

prokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, më pas edhe para ndërtesës së Qeverisë për ta kërkuar shkarkimin e Lumezit nga detyra dhe nisjen e një procesi të vetingut në drejtësi. Duke folur para protestuesve në fund të

marshit, aktivisti Shkëlzen Gashi ka numëruar dy arsytet e protestës. "Arsyeja e parë është se Aleksandër Lumezi është caktuar në këtë pozitë nga politika, nga 'Pronto'. Bisedat në mes të Kadri Veselit dhe Adem Grabovcit tregojnë qartë se

Aleksandër Lumezi është dorë e zgjatur e personave të korruptuar. I gjithë sistemi gjyqësor është i kapur nga persona të korruptuar. Arsyeja e dytë është ndërhyrja e tij (Lumezit) në hetimin e listave të veteranëve të luftës", ka thënë Gashi. Ndërsa drejtoresha e Rrjetit të Grave të Kosovës, Igballe Rogova, ka pohuar se protestuesit do të jenë në rrugë deri në realizimin e kërkesave. "Para dy vjetëve zgjodhën njeriun i cili do

t'ua lante të palarat e sot ky njeri kritikon për joprofesionalizëm prokurorin se nuk bëri punën si duhet. Kryeministri thotë se është hajn prokurori i cili e mbron paranë publike. Pastaj Kadri Veseli e quan prokurorin frikacak. Por ky prokuror guxoi të flasë. Ky sistem i politikës po përzihet në sistemin e drejtësisë duke i kërcënuar ata që po flasin të vërtetën. Ne do të vazhdojmë të protestojmë", ka thënë Rogova.

## Mblidhet Task Forca për koordinimin e punëve për aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën'

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 28 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në takim me Task Forcën për pastrimin e ambientit në Kosovë, e cila do të merret me organizimin e fushatës dhe aksionit "Ta pastrojmë Kosovën" nga 15 shtatori 2018 deri më 15 dhjetor, si dhe me ministrat e linjës, ofroi tërë mbështetjen për këtë aksion masiv duke u bërë thirrje qytetarëve t'i përgjigjen thirrjes për t'u bashkuar rreth këtij projekti madhor për vendin. "Qeveria, Kosova, institucionet e vendit të

të gjitha niveleve, organizatat që merren me ambient, që i kemi këtu, të gjithë bashkë, jemi duke punuar për t'i bërë përgatitjet që më 15 shtator ta fillojmë me sukses aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën' që do të zgjasë deri më 15 dhjetor", kështu ka thënë kryeministri Haradinaj pas takimit me mediat.

Për mbarëvajtjen e kësaj nisme është duke u punuar në dy nivele, në nivelin e koordinimit ndërministror, institucional dhe me organizatat e tjera si dhe në grupin teknik për mbarëvajtje të aksionit. "Jam optimist se ky aksion këtë herë do ta bëjë difer-



encën. Pra, për këta tre muaj do ta pastrojmë Kosovën dhe njëkohësisht pas tre muajve s'do të lejojmë të mbushet më me mbeturina", tha kryeministri Haradinaj. "Qëllimi është që ta pastrojmë Kosovën në këta tre muaj dhe do të sigurohemi që të kemi bazë ligjore që nuk ka qenë

deri më tash, që ndotësit e ambientit të ndëshkohen", ka thënë ushtruesi i detyrës së ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi. Albena Reshitaj, këshilltare e kryeministrit Haradinaj, ka thënë se ndihet e lumtur që është pjesë e kësaj kampanje, tashmë projekt shtetëror "Ta pastrojmë Kosovën", duke thënë se është hera e parë në historinë e vendit tonë që të gjithë aktorët institucionalë, por edhe shoqëria civile, do të jenë bashkë edhe do të bashkëpunojnë për krijimin e një ambienti më të pastër i cili do të

ndikojë në cilësinë dhe mirëqenien të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Koordinatori i "Let's Do It Kosova", Luan Hasanaj, duke përshëndetur nismën për pastrimin e Kosovës, tha se është i vetmi rast në rajon që të gjithë aktorët bëhen bashkë për ta pastruar vendin nga ndotja. "I tërë rajoni është i ndotur, jo vetëm Kosova, kemi mbetje gjithandej, por asnjëra nga qeveritë e rajonit nuk ka bërë këtë hap i cili është për t'u përshëndetur", ka thënë Hasanaj, i bindur se edhe qytetarët do të japin kontribut në aksionin për pastrimin e Kosovës.

## Lumezi, Apostolovës: Po marrim veprime për përfundimin e rastit të veteranëve të UÇK-së

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka pritur të mërkurën në takim shafen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova. Lumezi e ka njoftuar shafen e BE-së me funksionimin dhe efikasitetin e Prokurorit të Shtetit, duke theksuar se prokurorët janë të vendosur dhe të gatshëm të kontribuojnë për forcimin e sundimit të ligjit

si dhe për t'u përballuar me sfida që i ka ky institucion. Gjatë këtij takimi Lumezi dhe shefja e BE-së kanë diskutuar edhe për rastet të cilat janë shenjësuar nga Prokuroria për liberalizimin e vizave si dhe për rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Lumezi ka potencuar se institucioni i Prokurorit të Shtetit është duke ndërmarrë të gjitha

veprimet e nevojshme për përfundimin sa më të shpejtë të rastit të veteranëve dhe për dërgimin e akteve përkatëse në Gjykatën Kompetente ashtu siç e përcakton ligji. Ndërsa shefja e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka premtuar se BE-ja do ta vazhdojë ta përkrahë institucionin e Prokurorit të Shtetit në drejtim të forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë.



Sot (e enjte) në Kosovë shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave të Zhdukur

## Dialogu të kushtëzohet me ndriçimin e fatit të personave të zhdukur

Kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Prenk Gjetaj, ka kërkuar nga autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që çështja e të zhdukurve të bëhet pjesë e agjendës së dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë të mërkurën për gazetën "Epoka e re" se vazhdimi i dialogut duhet të kushtëzohet me ndriçimin e fatit të personave të zhdukur. Por, Gjetaj ka treguar se aktualisht bashkësia ndërkombëtare nuk ka gatishmëri që çështja e të zhdukurve të bëhet pjesë e bisedimeve që po zhvillohen në Bruksel

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur sot (e enjte) në Kosovë do të mbahet marsh përkujtimor në shenjë nderimi për personat e zhdukur. Kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Prenk Gjetaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky marsh ka për qëllim sensibilizimin e çështjes së personave të zhdukur në mënyrë që pala serbe ta tregojë vendndodhjen e 1 648 personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. "Ditën Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur e shënojmë në shenjë nderimi dhe kujtimi për të gjithë ata që kanë qenë të zhdukur dhe për ata që vazhdojnë të jenë të zhdukur, fati i të cilëve ende nuk dihet. Përveç përkujtimit dhe nderimit, marshi përkujtimor ka për qëllim edhe sensibilizimin e kësaj çështje në mënyrë që të ndikohet më tepër tek pala serbe që është përgjegjëse si dhe ka informata për vendndodhjen e personave të zhdukur. Bashkësia ndërkombëtare duhet t'u bëjë presion autoriteteve të Beogradit dhe t'i detyrojë të japin informata se ku gjenden varrezat masive dhe individuale, sepse 1 648 persona diku janë dhe nuk i ka lëshuar toka. Me këtë marsh i bashkohemi mbarë botës dhe ndajmë dhimbjen me familjarët e personave të zhdukur", është

shprehur Gjetaj.

Me këtë rast ai u ka bërë thirrje autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare që çështja e personave të zhdukur të bëhet pjesë e agjendës së bisedimeve të Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kërkojmë që dialogu që po zhvillohet me palën serbe për persona të zhdukur në formë të grupit punues nën drejtimin e komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të ngrihet në nivel të bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë për arsye se atje mund të ketë efekte më të mëdha dhe politika mund t'i hapë rrugë gjetjes së personave të zhdukur sepse këta persona janë marrë dhe janë vrarë për çështje politike. Pala serbe nuk ka mundur të pajtohet asesi se Kosova po i del nga dora dhe në shenjë hakmarrje dhe në pamundësi për t'u ballafaquar me forcat e NATO-s dhe tona, atëherë është hakmarrë duke vrarë civilë të pambrojtur - gra, fëmijë e pleq - me të vetmen arsye se kanë qenë shqiptarë. Do të thotë, nuk ka mundur kurrësi të pajtohet me faktin se po i del nga dora Kosova, prandaj ka vepruar në mënyrë më të egër dhe barbare, duke vrarë e masakruar si dhe duke i humbur gjurmët e krimeve që ende vazhdojnë të jenë këtu sepse njerëzit që kanë kryer veprime kriminale vazhdojnë të lëvizin lirshëm", ka theksuar Gjetaj.

Megjithatë, ai ka treguar se bashkësia ndërkombëtare nuk

ka gatishmëri që çështja e personave të zhdukur të bëhet pjesë e bisedimeve të Brukselit. Por, pavarësisht prej kësaj, Gjetaj ka thënë se vazhdimi i dialogut duhet të kushtëzohet me ndriçimin e fatit të personave të zhdukur. "Edhe pse autoritetet tona kanë qenë që çështja e personave të zhdukur të futet në agjendë të bisedimeve, mirëpo sipas informacioneve që unë kam, bashkësia ndërkombëtare nuk ka qenë e gatshme që këtë çështje ta trajtojë dhe ta fusë në agjendën e bisedimeve me palën serbe. Por, do të ishte me rëndësi

dhe interes që çështja e të pagjeturve të futet në agjendën e bisedimeve. Madje unë kam thënë dhe insistoj që hapat e mëtuftjeshëm të bisedimeve duhet të kushtëzohen me ndriçimin e fatit të personave të zhdukur", ka thënë Gjetaj.

Kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Prenk Gjetaj, ka bërë me dije se janë në pritje të raporteve për t'i ditur rezultatet e incizimeve të fundit që janë bërë në tri lokacione ku dyshohet se ka varreza masive ose individuale. "Javën e kaluar është bërë një vlerësim me një

aparaturë të huazuar nga Kombet e Bashkuara në tri lokacione, një në Kosovë dhe dy në Serbi, dhe tani po presim rezultatet, gjegjësisht raportet nga ekspertët, se çfarë mund të ketë. Do të thotë, kjo aparaturë mund të detektojë nëse ka eshtra me origjinë njerëzore. Ekspertët ndërkombëtarë i kanë bërë incizimet në këto tri lokacionet e lartpërmendura. Duhet t'i gjejmë varrezat masive apo edhe individuale sepse 1 648 persona mungojnë dhe tash duhet t'i kërkojmë se ku gjenden", ka theksuar Gjetaj.

## Policia arreston 17 të dyshuar për përfshirje në veprimtari penale

**PRISHTINË, 29 GUSHT (ER)** - Policia, konkretisht Njësia për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (NjHTQNj) në Prishtinë, pas një hetimi paraprak, më 28 gusht ka zbatuar një plan taktik ku ka arrestuar 14 (katërmëdhjetë) të dyshuar. Tre (dy femra dhe një mashkull) të dyshuar janë arrestuar për përfshirje në veprat penale: "Mundësim ose detyrim në prostitucion" dhe "Ofrim i lokaleve për prostitucion", kurse 11 (njëmbëdhjetë) të dyshuar të tjerë për

"Marrje me prostitucion". Lidhur me rastin është njoftuar prokurorja kujdestare, me aktvendim të saj, të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt. Po ashtu, më 28 gusht NjHTQNj në Ferizaj, pas një hetimi të bërë, ka arrestuar një të dyshuar për përfshirje në veprën penale "Mundësim dhe detyrim në prostitucion". Në konsultim me prokurorin e rastit të Prokurorisë Themelore Ferizaj, i dyshuari lirohet, ndërsa lënda shkon në procedurë të rregullt.



Më 28 gusht NjHTQNj në Gjilan ka arrestuar dy persona të dyshuar për shkak të dyshimit të bazuar për 'Marrje me prostitucion'. Personat e arrestuar, pas kompletimit të rastit, janë dërguar me procedurë të shpejtë në Gjykatën Themelore në Gjilan. Policia mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave kushtetuese dhe ligjore për të ofruar rend dhe siguri publike, luftuar aktivitetet kriminale, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore.

# Agjenda ekonomike sfidohet nga p



Dyshimi për fryrjen e listave të veteranëve të UÇK-së, shkëmbimi i territoreve, demarkimi i kufijve, Gjykata Speciale dhe krijimi i ushtrisë janë disa prej temave politike që kanë ndikuar që ekonomia të mbetet e sfiduar. Sipas njohësve ekonomikë dhe afaristëve, politika ditore është duke e lënë nën hije mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 29 gusht** - Profesori universitar i ekonomisë, Berim Ramosaj, dhe afaristi Shaqir Palushi, kanë theksuar se fokusimi i lidershit në tema ditore politike ka lënë nën hije agjendën ekonomike në vend. Ramosaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se orientimi i lidershit të Kosovës kah temat

politike është duke e stagnuar agjendën ekonomike, e cila pastaj po ndikon drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe ndërmarrësve.

Ai ka thënë se duke u marrë vetëm me çështje politike janë duke u harruar çështjet e mëdha ekonomike të cilat ndikuan drejtpërdrejt në buxhetin e shtetit siç është rasti i pagesës në shumën prej 53 milionë eurosh ndaj 'Bechtel

Enka'-s. "Orientimi i politikës së Kosovës është kah çështjet e mëdha politike, duke mos u marrë kështu me çështjet e përditshmërisë së qytetarëve. Si rrjedhojë janë harruar edhe skandalet që kanë ndodhur në buxhetin e Republikës së Kosovës, është harruar edhe pagesa e mbi 50 milionë eurove që duhet t'i bëhet kompanisë 'Bechtel Enka'. Gjithashtu, i kanë lënë në harresë edhe

shumë çështje të tjera", ka thënë Ramosaj, duke shtuar se mosrishikimi i buxhetit nga Qeveria Haradinaj ka bërë që shumë kërkesa të qytetarëve dhe të bizneseve të mbesin të paadresuara. "Edhe pse kanë të drejtë që mos ta rishikojnë buxhetin, do të ishte mirë të rishikohej, por këtë mundësi nuk e ka shfrytëzuar Qeveria, duke marrë parasysh se nuk ekziston ekuilibër në mes të të hyrave potenciale të buxhetit të këtij viti, andaj ka qenë mundësi e mirë për të gjithë aktorët ndërmarrës që të rishikohet buxheti. Po ashtu, këtu është në pyetje edhe numri i votave dhe roli i opozitës që ka bërë që mos të rishikohet bux-

heti dhe të mos analizohen shumë çështje ekonomike", është shprehur Ramosaj.

Ndërkaq Shaqir Palushi, pronar i kompanisë "Frutex", ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është për keqardhje fokusi i Qeverisë vetëm në çështjet politike. "Fatkeqësisht, në rend dite nuk vjen çështja e zhvillimit ekonomik pasi çdoherë dalin tema të reja të cilat e pengojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës. Vetë fokusi i Qeverisë përqendrohet në temat politike, kurse në anën tjetër është edhe më keq që investitorët e mundshëm potencialë tremben vazhdimisht nga zhvillimet politike në vend. Po ashtu, jemi dëshmitarë që shumë kompani të fuqishme dhe miq të Kosovës



# olitika ditore



nuk investojnë në Kosovë, por shkojnë në vendet e rajonit, sidomos në Serbi, prandaj agjenda politike shpeshherë e ka dëmtuar zhvillimin ekonomik të vendit", ka thënë Palushi. Ai ka shtuar se sfida me të cilën vazhdojnë të përballen bizneset e Kosovës tashmë është dashur të jetë e harruar. Palushi ka theksuar se sfida mbesin energjia elektrike, mungesa e atashëve ekonomikë dhe mosliberalizimi i vizave. "Ka sfida dhe probleme të ndryshme me të cilat ballafaqohemi si prodhues. Një prej tyre është furnizimi me energji elektrike, qasja në tregjet ndërkombëtare, për faktin se në këtë drejtim ka kufizim, gjithashtu edhe mosliberalizimi i vizave

është duke ndikuar në stagnim të prodhuesve të Kosovës", ka thënë Palushi, duke shtuar se sa i përket lobit ekonomik apo diplomacisë ekonomike, gjithmonë ka munguar një qasje më pragmatike. "Nuk e di çfarë bëjnë ambasadat dhe njerëzit tanë atje sa i përket zhvillimit ekonomik të Kosovës. Shikoni ambasadat e huaja, janë shumë aktive në agjendën ekonomike të shteteve që përfaqësojnë. Na ka rastisur shumë kur partnerët tanë vijnë të na vizitojnë, ata janë të shoqëruar nga përfaqësuesit ekonomikë të ambasadave, kurse nga Kosova nuk ka ndodhur asnjëherë, edhe se vazhdimisht shoqërohemi nga atashetë ekonomikë", është shprehur Palushi.



## Nis projekti i autostradës 91 kilometra

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, të mërkurën ka nënshkruar kontratën për "Hartimin e projektit zbatues për ndërtimin e autostradës Istog - Pejë - Deçan - Gjakovë - Prizren". Rruga që do t'i lidhë këto qytete

do ta ketë gjatësinë 91 kilometra. Vlera e kontratës së projektimit është 1,039,532.80 euro dhe do të përfundojë brenda 16 muajsh, ndërsa punëkryes është konsorciumi "Infra Plus & Infra Tek", Prishtinë. Në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës

është bërë me dije se ky është edhe një hap më tepër i Qeverisë Haradinaj, konkretisht Ministrisë së Infrastrukturës, drejt lehtësimit të qarkullimit të qytetarëve të Kosovës, duke afruar qytetet mes vete me rrugë të standardeve evropiane.



## Ministria e Infrastrukturës merr iniciativë për pastrimin e rrugëve

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Ekipe të kompanisë së kontraktuar janë duke punuar për pastrimin e vegetacionit të brezit rrugor përgjatë rrugës Orllat - Bresje, me gjatësi 25 kilometra. Të tilla punime përgjatë gjithë muajit do të ndodhin edhe në aksin rrugor Bresje - "Arbën Xhaferi" - Veternik - Besi, me gjithsejtë 40 kilometra.

Punimet që kanë nisur të mërkurën doli t'i inspektojë edhe zëvendësministri Rexhep Kadriu, i cili shprehi këmbëngulësinë e ministrit të infrastrukturës, Pal Lekaj, për mirëmbajtje të të gjitha rrugëve rajonale dhe autostradave.

Njëkohësisht Ministria e Infrastrukturës paralajmëron fil-

limin e aksionit të madh të brezit rrugor me moton "Ta pastrojmë Kosovën" më 15 shtator.

Zëvendësministri Kadriu ka kërkuar nga qytetarët që hasin në ekipe punuese të kenë mirëkuptim për pengesa të mundshme në komunikacion dhe ta shtojnë kujdesin e tyre gjatë vozitjes në këto pjesë.

## Guvernatori i BQK-së përkrah Shoqatën e Sigurimeve të Kosovës

Prishtinë, 29 gusht (ER) - Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku, është takuar me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi

Mehmetin, të cilin e ka njoftuar për aktivitetet e fundit të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës. Mazreku ka bërë me dije se guvernatori i BQK-së e ka vlerësuar punën e Shoqatës së



Sigurimeve të Kosovës dhe i ka ofruar përkrahje institucionale.

## Muharremaj paralajmëron masa për ndotësit e ambientit

SUHAREKË, 29 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka paralajmëruar masa ndëshkuese ndaj të gjithë atyre që ndotin ambientin. Muharremaj ka bërë me dije se do të vendosin edhe kamera për t'i

identifikuar ndotësit e ambientit. "Kjo pamje nuk na ka hije. Lumi 'Toplluha' në këtë pjesë është pas-truar disa herë, por persona të pandërgjegjshëm ende po hedhin mbeturina. Ju njoftojmë se në të ardhmen do të merren masa në

përputhje të dispozitave ligjore në fuqi, me dënime për ata që e dëmtojnë ambientin. Po ashtu, do të vendosen edhe kamera që t'i identifikojmë ata që po e prishin imazhin e lumit të pastër", ka deklaruar Muharremaj.



## MMPH-ja ndan 50 mijë euro për deponinë e mbeturinave në Pejë

PEJË, 29 GUSHT (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, dhe kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, kanë nënshkruar të mërkurën një marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit "Ndërtimi i deponisë komunale në regjionin e Pejës" në vlerë prej 50 mijë eurosh për vitin fiskal 2018 dhe që financohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të këtij memorandumi, Matoshi ka thënë se ndërtimi i kësaj deponie ka për qëllim përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Pejë. Ndërsa kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka falënderuar MMPH-në për financimin e projektit për ndërtimin e deponisë në komunën që ai drejton, duke thënë se ky është një fillim i mbarë për bashkëpunimin që do të ndodhë edhe në të ardhmen.



## Të hënën Prishtinës i shtohen edhe 21 autobusë të rinj

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se javën e ardhshme do të vijjnë në kryeqytet edhe 21 autobusë të tjerë të Trafikut Urban. Ai ka thënë se autobusët e rinj do të dalin në qarkullim nga 1 tetori i këtij viti. "Edhe 21

autobusët e tjerë sot nisen nga fabrika. Të hënën janë në Prishtinë, ndërsa nga 1 tetori do të jenë në qarkullim edhe në linja të tjera përpos 1, 3 dhe 4. Vazhdojnë prioritetet e reja dhe implementimin e linjave të reja", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

## Komuna e Gjilanit subvencionon bletarët me 30 centrifuga elektrike

GJILAN, 29 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, dhe drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, kanë përgëzuar përfituesit e 30 centrifugave elektrike për bletari dhe kanë garantuar rritjen e buxhetit për sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2019. Haziri ka thënë se baza e zhvillimit lokal ekonomik në Anamoravë mbetet bujqësia, e cila, sipas tij, është qeliza e zhvillimit dhe baza kryesore që do t'i vazhdojmë investimet dhe rritjet e subvencioneve.

Ndërsa drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ka theksuar se në vazhdimësi janë duke i përkrahur bletarët gjilanas. "Në Gjilan nuk ka bletar që ka mbi 30



bletë e që nuk është pajisur me centrifugë elektrike", ka thënë Ramadani. Ai ka bërë me dije se Gjilani ka 297 bletarë, prej të cilëve 101 bletarë kultivojnë mbi

30 shoqëri bletësh e 196 të tjerë kanë më pak se 30 shoqëri bletësh që, mbledhur të gjithë, në Gjilan janë gjithsejtë 6 700 shoqëri bletësh.

## Komuna e Skenderajt mbështet fermerët me projekte në bujqësi

SKENDERAJ, 29 GUSHT (ER) - Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBZHR) ka mbajtur sesionin informues me fermerë të Komunës së Skenderajt, me qëllim të informimit rreth subvencioneve dhe mbështetjes që komuna do të ofrojë për fermerët gjatë muajve në vazhdim. Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Sokol Sallahu, ka informuar fermerët se në sektorin e perim-

tarisë do të mbështeten 10 fermerë me nga 1 ari serrë, në sektorin e bletarisë do të mbështeten 53 fermerë me nga pesë komplete koshere të bletëve, veshmbathje dhe tymose, ndërsa në sektorin e blegtorisë do të mbështeten 80 fermerë me makina mjelëse. Gjatë këtij takimi fermerët janë informuar për plotësim të aplikacionit dhe dokumenteve të nevojshme që kërkohen për aplikim.



Krejt njëjtë! (3)

# Z. Blakaj lëshoi mundësinë të jetë hero i gjallë i Kosovës së pasluftës

*Komandantë të UÇK-së, deputetë e qeveritarë, kryetarë partish politike, kryetarë komunash, gazetarë, prokurorë gjykatës, qytetarë...!*



YLBER ÇITAKU

Si rezultat i këtyre veprimeve shantazhuese sot kemi gazetarë që brenda një kohe relativisht të shkurtër janë persona me shumë ndikim te liderët e partive politike; janë pronarë ose aksionarë të medimeve me vlerë disamilionëshe deri në dhjetëramilionëshe; janë pronarë ose aksionarë të gurthyesve, kompanive, bordeleve, hoteleve e patundshmërive me vlera prej disa milionëshe në disa dhjetëramilionëshe. Sigurisht se profesioni i gazetarisë është profesion i shenjtë, por që gazetarët e Kosovës në shumicën absolute të rasteve këtë profesion e kanë shfrytëzuar për ta materializuar për interesa dhe përfitime personale duke lënë krejtësisht anash profesionalizmin; profesionalizmi i gazetarit është interes i qytetarit, interes i vendit dhe i botës së qytetëruar e demokratike. Si rezultat i krejt kësaj në Kosovën e pasluftës kemi pasur gazetar deputet, gazetar ministër e zëvendësministër, madje kemi pasur edhe gazetar që kanë shkruar në vende të ndryshme të botës si ambasador e konsull, por nuk më kujtohet as edhe një rast i vetëm që një gazetar nga Kosova të ketë shkruar si gazetar në ndonjë media me nam botërore!

## Prokurorë e gjykatës

Se sistemi i drejtësisë është sistemi më i ndjeshëm i një shoqërie e kemi kuptuar edhe ne laikët e kësaj fushe, në fakt për qytetarët e Kosovës gjykatat dhe prokuroritë nuk është se janë segmente të panjohura, përkundrazi popullata shqiptare si popullatë numerikisht shumicë absolute në Kosovë ka qenë bukur shumë e "familjarizuar" me gjykatat dhe prokuroritë sidomos pas vitit 1981, vit pas të cilit kaluan nëpër dyert e prokurorive dhe gjykatave shumica e shqiptarëve të Kosovës e ku afërsisht çdo i dyti nga ta u dënua prej disa muajsh në disa dekada.

Edhe në Kosovën e pasluftës janë dënuar kriminelë, zyrtarë e personalitete që në opinion njihen si njerëz me ndikim, në këto dënime pjesë e prokurorisë dhe trupës gjyqësore kanë qenë kosovarët, madje pjesë e këtyre ekipeve

prokurorësh e gjyqtarësh kanë qenë edhe individë nga sistemi i kaluar jugosllav e serb, por që të njëjtit për këto raste nuk kanë pasur as edhe një pasojë.

Ditët e fundit një prokuror dha dorëheqje. Opinioni u njoftua për dorëheqjen e prokurorit Elez Blakaj. Asgjë e jashtëzakonshme deri në momentin kur doli informacioni se i njëjti ka dhënë dorëheqje pasi që në dorë kishte një rast të ndjeshëm e për pasojë ishte kërcënuar. Personalisht u ndjeva keq, keqardhje ndienin edhe familjarët e miqtë me të cilët komunikoj në baza ditore, për aq sa arrija t'i përcilla mediet dhe rrjetet sociale, keqardhje pati pothuajse nga të gjithë.

Keqardhja ime erdhi duke u zbehur kur dëgjova deklaratat e z. Blakaj, deklarata këto kontradiktore dhe që më asocionin në insinuat. Keqardhja ime për rastin e prokurorit Blakaj u tret krejtësisht kur kuptova se i njëjti dorëheqjen e kishte bërë me paramendim dhe për interesa krejtësisht personale dhe se i njëjti ishte rehatuar në ShBA me krejt familjen.

Është e drejtë e secilit individ ta bëjë zgjedhjen për vete dhe familjen, por të ngrehën intriga e insinuat se ka qenë i kërcënuar e i shantazhuar nga persona anonimë, besoj se nuk i bën nder askujt. E thashë më herët se në Kosovë ka pasur dënime me e pa fakte të njerëzve që në opinion njihen si njerëz me ndikim dhe askujt nga gjyqësori as edhe një qime e flokut nuk i ka munguar.

Duke përdorur thënien e të madhit Adem Demaçi "Kurrë mos thuaj kurrë", thënie kjo e përdorur në një rast tjetër dhe në kontest krejt tjetër, nuk kisha dashur të kuptohem se po e nënvlerësoj ndjeshmërinë e rastit të prokurorit Elez Blakaj, por gjykuar sipas opinionit të përgjithshëm nuk do të kishte rrezikshmëri të lartë, përkundrazi do të kishte mbështetje jashtëzakonisht të madhe nga shumë sfera në Kosovë.

Fillimisht dhe më e rëndësishmja është mbështetja institucionale e ministrit të drejtësisë, z. Abelard Tahiri, i cili tash e një vit zëshëm proklamoi mbështetjen në të gjitha sferat për gjyqësorin. Nuk është pa vlera edhe mbështetja morale, po edhe duke ofruar dëshmi e fakte për rastin edhe nga vetë veteranët dhe segmente të tjera të shoqërisë.

Por për njeriun që i mungon profesionalizmi, vullneti dhe përkushtimi, të kota janë mbështetjet anësore, pavarësisht të çfarë niveleve a përmasave do të ishin ato mbështetje, në rastin e prokurorit Blakaj, përjashto

aspektin profesional për të cilin nuk ndihem i nivelit për ta vlerësuar, aspektet e tjera i kanë munguar, rrjedhimisht për mua është një dezertor.

Elez Blakaj më kthen në kohën e luftës, kohë kjo kur, përveç atyre që u bashkoheshin radhëve të lavdishme të UÇK-së, ka pasur edhe raste të dezertimit, të njëjtit sot kanë certifikata të veteranit, edhe z. Blakaj dezertoi, por kjo nuk do të thotë se ai nuk ka licencën e prokurorit.

Z. Blakaj lëshoi mundësinë të jetë hero i gjallë i Kosovës së pasluftës. Kishte mundësinë e artë t'i çonte prapa grilave me qindra, pse jo me mijëra mashtrues e përfitues, por z. Blakaj zgjodhi luksin. Është e drejtë e tij përzgjedhja e bërë, por nuk është korrekte të moralizojë te kolegët e të viktimizohet tek opinioni i gjerë.

Në botë ka shumë raste kur prokurorët, pavarësisht prej rrethanave, ua tregojnë vendin keqbërësve. Këto raste shumë më mirë i di z. Blakaj. Vogëlsia ime po i evidenton dy raste kur prokurorët kanë qenë profesionalë, por edhe kanë pasur gatishmëri e vullnet për ta ndihmuar vendin e tyre.

Botërisht dihet se mafia italiane është organizata kriminale me e organizuar në botë. Rrjedhimisht, është organizata kriminale më e rrezikshme, por prokurorët italianë Gjovani Falcone dhe Paolo Borsellino në vitet '80-'90 i hynë punës me profesionalizëm e përkushtim (edhe pse e dinin se do të vriten) ku brenda një kohe të shkurtër quan prapa grilave me mijëra e mijëra individë qofshin ata politikanë, policë, gjyqtarë, prokurorë, kryetarë bashkish, madje si rezultat i punës së tyre me përkushtim e profesionalizëm diku rreth një vit pas vrasjes së tyre u arrestua edhe kryemafiozi me nam botëror, Salvatore Toto Rina.

Prokurorja rumune Laura Kodruta Kovesi para pak vitesh për një kohë të shkurtër ka hetuar mbi 6 000 raste, kurse ka ngritur 1 200 aktakuza kundër personaliteteve të ndryshme, si: senator, polic, drejtor, kryetarë komunash, ministra e deri edhe ndaj kryeministrit Viktor Ponta i cili dha dorëheqje. Si rezultat i meritës dhe punës së guximshme e profesionale të prokurorës Laura Kodruta Kovesi Rumania ka ecur me hapa të sigurt drejt BE-së.

I nderuari z. Blakaj, kolegja juaj rumune kishte mundësi shkollimi e avancimi profesional në vendet perëndimore,

I nderuari z. Blakaj, kolegja juaj rumune ishte e re e bukur, sigurisht që e donte familjen dhe jetën

por, mbi të gjitha, e donte profesionin dhe vendin,

I nderuari z. Blakaj, kolegja juaj rumune sigurisht nuk pretendon se ka çrrënjësuar korrupsionin, mashtrimet dhe dukuritë negative në Rumani por, si rezultat i veprimeve të saj, janë hapur mbi 1 200 raste gjyqësore dhe janë konfiskuar me qindra milion euro. I nderuar z. Blakaj, kolegët tuaj italianë dhe rumunë janë prokurorë heronj në vendet e tyre, z. Elez Blakaj ju jeni një prokuror dezertor!

## Qytetarë

Sipas Entit të Statistikave të Kosovës, jemi 1.8 milion banorë.

A ka mundësi të jemi të gjithë mashtrues, të korruptuar, dezertorë, të djallëzuar, intrigantë, dembelë...?!

Nuk e besoj, edhe sikur unë ose kushdo qoftë ta besoj, nuk ka mundësi teorike.

A ka mundësi që nga depresioni të kemi rënë në një koma kolektive?! Nuk e besoj, edhe sikur unë ose kushdo qoftë ta besojë, nuk ka mundësi teorike.

A ka mundësi të jemi të gjithë të kënaqur me gjendjen dhe mirëqenien qytetare të këtij vendi?!

Nuk e besoj, edhe sikur unë ose kushdo qoftë ta besojë nuk ka mundësi teorike.

A ka mundësi që mashtruesit, të korruptuarit, dezertorët, intrigantët dhe dembelët të jenë numerikisht më shumë sesa qytetarët punëtorë, qytetarët besnikë, qytetarët e sinqertë e korrektë të këtij vendi?!

Nuk e besoj, edhe sikur unë ta besoj, askush nuk duhet ta besojë, thjesht duhet ta nxjerrim një duf inati nga vetja, nga qenia jonë njerëzore dhe të themi se të korruptuarit, dezertorët, intrigantët e mashtruesit janë një e keqe që na kanë dalë në rrugën, por të tillët do t'i mundim.

Populli i Kosovës ka mundur të këqija edhe më të mëdha, fatmirësisht këto të këqija kanë ardhur nga armiq të tanë shekullorë.

Sigurisht se gjetja e motivit për t'i luftuar të këqijat që kanë ardhur nga armiq të jashtëm ka qenë më e lehtë, por edhe për mundjen e të keqes së brendshme që e ka kapluar shoqërinë tonë duhet gjetur motivin.

Motivin duhet ta gjejmë në vuajtjet e të parëve tanë, në gjakun e dëshmorëve, në vuajtjet që kemi përjetuar edhe vetë ne, në ardhmërinë e fëmijëve tanë, rrjedhimisht keqpërdorimi i mirësisë qytetare na obligon të reagojmë deri në pengimin, ndalimin dhe ndëshkimin e së keqes! **(Fund)**

## Trumpi paralajmëron 'dhunë' nëse fitojnë demokratët

UASHINGTON, 29 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump ka paralajmëruar se politikën e tij do të përmbysen "dhunshëm" nëse demokratët do të fitojnë në zgjedhjet kongresionale që mbahen në muajin nëntor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ai u ka thënë liderëve evangjelistë se vota është "referendum" për liri të shprehjes dhe religjionit dhe se këto të fundit janë duke u kërcënuar nga "persona të dhunshëm". Ai u ka bërë thirrje për ndihmë grupeve konservatore krishtere, duke

thënë se ata janë vetëm një votë larg "humbjes së çdo gjëje". Zgjedhjet për Kongres janë duke u cilësuar si test për popullaritetin e presidentit amerikan. Trumpi është përballur me publicitet negativ prej kur ish-avokati i tij, Michael Cohen dhe ish-drejtuesi i fushatës së tij, Paul Manafort, janë shpallur fajtorë më herët gjatë këtij muaji. Gjatë takimit të tij me grupet evangjeliste, Trumpi ka thënë se zgjedhjet e ardhshme nuk janë vetëm referendum për të, por edhe për "religionin tuaj, refer-

endum për lirinë e shprehjes dhe amendamentit të parë". "Nuk është në pyetje pëlqimi apo jo. Është në pyetje se ata do të përmbysin gjithçka që kemi bërë dhe do ta bëjnë atë shpejt dhe dhunshëm. Kjo është dhunë. Shikoni antifashistët, ata janë njerëz të dhunshëm", është shprehur Trumpi. Me termin antifashistë, Trumpi u është referuar grupeve të së majtës ekstreme të cilët luftojnë ideologjinë e së djathtës ekstreme dhe përleshjen me protestuesit që mbështesin ideologjinë e kundërt.



## Rusia ndërton flotë detare në Mesdhe teksa tensionet rriten në Siri

Rusia është duke u përgatitur për praninë më të madhe detare në Mesdhe, prej ndërhyrjes në Siri më 2015, duke kthyer situatën në favor të Assadit

MOSKË, 29 GUSHT - Rusia ka pozicionuar disa anije luftarake në Detin Mesdhe, në atë që mediet ruse e kanë cilësuar si prania më e madhe në këtë pjesë, prej kur Rusia ka ndërhyrë në luftën civile siriane më 2015. Këto përf forcime kanë ardhur pasi aleati i Rusisë, presidenti sirian Bashar al-Assad, besohet se është duke përgatitur një sulm në provincën veriore Idlib, e cila është enklava e fundit e zotëruar nga rebelët.

Drejtori humanitar i Kombeve të Bashkuara, John Ging, ka paralajmëruar më 28 gusht se një ofensivë qeveritare e përmasave të mëdha, "ka kapacitet të krijojë urgjencë humanitare të shkallës së paparë deri më tash" sa i përket konfliktit shtatëvjeçar në Siri. Ky hap vjen edhe në kohën kur Shtetet e Bashkuara, Britania dhe Franca kanë përsëritur në një takim të Këshillit të Sigurimit një ditë më parë që Siria, ushtria e së cilës është mbështetur nga forca ajrore ruse, të mos përdorë ndonjë armë kimike në sulmin në Idlib, duke thënë se një veprim i tillë do të rezultojë me hakmarrje perëndimore.

Rusia ka cituar paralajmërimin e fuqive perëndimore në ditët e fundit për t'i akuzuar Shtetet e Bashkuara për krijim të rrethave të saj në Lindje të Mesme, rreth ndonjë sulmi të mundshëm kundër forcave qeveritare siriane, ndonjëse ky pretendim është

mohuar nga Pentagoni.

Akuzat ruse kanë ardhur pavarësisht se mediet janë duke raportuar për bazën detare ruse në Mesdhe. Agjencia e lajmeve "Reuters" ka raportuar më 25 gusht se në disa pamje dhe fotografi është parë admiral rus, Grigorovich dhe admiral Essen duke lundruar përmes ngushticës së Bosforit në Stamboll drejt Mesdheut. Gazeta pro-Kremlinit, "Izvestia" ka thënë se Rusia është duke u përgatitur për praninë më të madhe detare në Mesdhe, prej ndërhyrjes në Siri më 2015, duke kthyer situatën në favor të Assadit.

Konflikti shtatëvjeçar në Siri ka lënë të vdekur më shumë se 400 000 persona dhe ka detyruar miliona të tjerë të shpërngulen nga shtëpitë e tyre.

Forca detare ruse në Mesdhe tani përfshin 10 anije, shumica e të cilave të armatosura me raketa me rreze të gjatë veprimi, ka raportuar "Izvestia", duke thënë se edhe disa të tilla janë në rrugë e sipër.

Në Kombet e Bashkuara drejtori humanitar John Ging u ka bërë thirrje anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të "bëjnë gjithçka që mundën për ta siguruar mënjanimin" e krizës humanitare në Idlib, provincë siriane në kufi me Turqinë, e cila është e populluar nga rreth 3 milionë banorë, duke



përfshirë shumicën e rebelëve sunitë dhe familjet e tyre.

Mediat ruse kanë cituar ministrin rus të Mbrojtjes, Sergei Shoigu, të ketë thënë më 28 gusht, se Ushtria ruse është duke tentuar të negociojë atë që e ka cilësuar "marrëveshje paqësore" me grupet rebele në Idlib, sikurse paktin e arritur me grupet rebele këtë vit në Gutan Lindore, përmes së cilës rebelëve do t'u ofrohej siguria në këmbim të dorëzimit të armëve.

Ndërkohë, në takimin e OKB-së, Rusia ka akuzuar sërish Komitetin për Çlirimin e Levantit, të lidhur me Al-Kaidën për përgatitje të kryerjes së sulmeve kimike në Idlib, për të cilat

Moska ka thënë se do të përdoren nga Perëndimi si arsytim për t'i sulmuar forcat siriane.

Rusia, po ashtu, ka pretenduar se forcat speciale britanike janë duke u ndihmuar rebelëve, duke përfshirë furnizimin me gaz klori, deklaratë e kundërshtuar ashpër nga ambasadorja britanike në OKB, Karen Pierce.

Duke i cilësuar këto pretendime si "lajme të rreme", ajo ka përsëritur deklaratën e shtetit të saj, Francës dhe Shteteve të Bashkuara, se në rast të përdorimit të këtyre armëve, shtetet në fjalë do të përgjigjen në mënyrë adekuate.

Ambasadori rus në OKB, Vasily Nebenzya, ka thënë se forcat e

armatosura siriane nuk kanë armë kimike dhe se nuk ka nevojë ushtarake për to. "Faleminderit për këtë paralajmërim të përgjigjes suaj", ka thënë Nebenzya.

"Ne, po ashtu, duam t'ju paralajmërojmë se jemi të vetëdijshëm për planet tuaja të neveritshme. Ne ju porosisim fuqishëm që t'i frenoni ato. Realizimi i planeve të tilla do të përballet me sulm kundër ndonjë rezultati paqësor në Siri", tha ai.

Ambasadorja britanike Pierce ka thënë se Rusia është duke bllokuar përpjekjet për krijimin e një konsensusi në mënyrë që të ketë plan veprimi të OKB-së për ta parandaluar katastrofën humanitare në Idlib.

## Qyteti gjerman largon statujën e Erdoganit

BERLIN, 29 GUSHT - Një statujë e presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan, e cila është ngritur gjatë një festivali në qytetin e Gjermanisë, Visbaden, u hoq pasi autoritetet thanë se është bërë kërcënim për sigurinë. Organizatorët e Festivalit të Artit, temë e të cilit janë "lajmet e këqija", e ngritën statujën katërmetër-

she të Erdoganit në një bazament në sheshin qendror të Visbadenit më 27 gusht.

Autoritetet thanë se ajo është bërë magnet për fjalimet për dhe kundër Erdoganit dhe se ka provokuar konflikt. Statuja është dëmtuar me grafitë, përfshirë sloganin "Hitleri turk" dhe disa qindra njerëz kanë protestuar

kundër saj. Policia tha se nuk mund të garantojë më sigurinë e njerëzve dhe zjarrfikësit përdorën një vinç të madh për ta hequr atë. Në Gjermani jetojnë rreth tre milionë njerëz me origjinë turke. Erdogani, i cili është rizgjedhur president në qershor, pritet ta vizitojë Berlinin më 28 dhe 29 shtator.



Lladrovci ofron dëshmi të shumta të diplomacisë dhe të qëndrimit të kundërt rus ndaj çështjes shqiptare për vite të tëra

# 162 vjet kundër shqiptarëve, rusomadhja

**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

"Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2018)" është libri studimor i Hamz Smajl Lladrovci, të cilin e ka nxjerrë nga shtypi para disa javësh e promovimin e të cilit do ta bëjë këtë të shtunë në sallën e "Grand Hotel"-it në Prishtinë. Libri i Hamzës ka shtatë kapituj, një shtojcë të veçantë me dokumente të ndryshme rreth çështjes shqiptare ndaj diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe. Po ashtu, ka edhe katër shtojca të tjera, në të cilat dokumentohen, me fotografi dhe me faksimile, qëndrimi i gjeopolitikës rusomadhe nga viti 1856 deri në vitin 2018 kundër Kosovës dhe gjithë popullit shqiptar. Por, para këtyre të dhënave, libri ka tre vlerësime për librin nga prof. dr. Eqrem Zenelaj, nga prof. dr. Muhamet Mala dhe nga prof. dr. Haxhi Ferati, të cilët çmojnë kontributin shkencor dhe dokumentar të Hamz Lladrovci sjell në këtë libër mbushur me dëshmi të shumta, të cilat ruhen nëpër arkiva të ndryshme të botës, ato më të vjetra veçanërisht në të Brukselit, të Parisit, të Vjenës, sidomos të Arkivit Qendror Shtetëror në Tiranë.

Prof. dr. Eqrem Zenelaj, në recensionin e vet për këtë libër, thotë se ky libër ka rëndësi të veçantë shkencore dhe historike, sepse autori në të trajton rivalitetet, shkaqet dhe gjeopolitikën, që nga gjeneza e tyre, mes diplomacisë shqiptare dhe ruse. Ndër të tjera, profesor Zenelaj thotë se Lladrovci në këtë libër ka punuar me sens shkencor dhe analitik, si njohës i marrëdhënieve ndërkombëtare, duke shtjelluar dhe argumentuar shkencërisht, se kjo gjeopolitika rusomadhe-sllave-ortodokse i ka rrënjët që nga viti 1856 dhe ka vazhduar hapur apo fshehurazi, për zgjerim terri-torësh dhe ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke favorizuar dhe mbështetur idetë pansllave - rusomadhja, deri në ditët e sotme, pasoja e së cilës politikë gjeografike bie mbi trojet shqiptare dhe Ballkanin. "Autori i librit me guxim dhe kompetencë

shkencore zgjedh për hulumtim dhe analizë një periudhë të caktuar interesante kohore të gjeopolitikës ruse, e cila daton që nga viti 1856 e deri në ditët e sotme", shkruan Zenelaj në vlerësimin e vet për librin e Lladrovci dhe shton se "autori, për ta realizuar këtë projekt shkencor dhe për ta publikuar këtë libër, ka hulumtuar dhe ka punuar mbi dy vjet nëpër arkivat e Brukselit, të Parisit, të Vjenës, sidomos të AQSh-së në Tiranë".

Duke shfletuar këtë libër, lexuesi sheh dokumente me vlerë shkencore, historike e kombëtare, të kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të Lidhjes së Pejës, të Kuvendit të Dibrës. Pastaj raportet e konsujve të huaj, si dhe dokumente e të dhëna të tjera autentike e origjinale të cilat ia shtojnë besueshmërinë shkencore këtij libri dhe e bëjnë të kuptueshëm dhe me mjaft argumente për lexuesin. Po ashtu, faksimile, vendime dhe të dhëna sekrete të organeve dhe të institucioneve partiake e shtetërore të Shtetit Shqiptar në kohën e Enver Hoxhës, e sidomos vendime të rëndësishme dhe të dhëna të panjohura sekrete dhe tejet interesante të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, si dhe të strukturave të tjera të larta shtetërore e partiake, sidomos në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, që tregojnë për vllimet politike e ushtarake në Shqipëri, si dhe raportet Enver - Stalin dhe Enver - Hrushqov. Të një rëndësie të veçantë janë edhe qëndrimet, por dhe vendimet e organeve partiake e shtetërore të Shqipërisë për gjykimin e akteve agresive të BRSS-së dhe të Paktit të Varshavës, të ndërhyrjes ushtarake në Hungari dhe në Çekosllovakia, por edhe vendimi i guximshëm i Shqipërisë për daljen e saj nga Pakti i Varshavës.

Pa dyshim se Hamz Lladrovci, duke qenë në dijeni të të gjitha zhvillimeve historike-diplomatike që ka shkruar në libër, duke pasur dijen historike dhe përkrahjen e prof. dr. Eqrem Zenelaj, me këtë libër, thotë profesor Muhamet Mala, plotëson një zbrazëtitirë të mbetur studimore, duke na afruar një

**PROMOVIM**

Mr. sci. Hamz S. Lladrovci

**ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALL DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSO-MADHJE 1856-2018**

Mr. sci. Hamz S. Lladrovci

Promovimi i librit mbahet më:

**01.09.2018** (e shtunë)  
në orën **12:00** në  
**Hotel Grand** në Prishtinë. (Salla solemne)

tablo të raporteve dhe qëndrimit të diplomacisë ruse ndaj shqiptarëve që nga Konferenca (Traktati) e Parisit e vitit 1856, kur fuqitë evropiane ndërhyjnë ushtarakisht kundër Rusisë së atëhershme, duke mbështetur Perandorinë e dobësuar Osmane, si dhe duke e afruar atë në të ashtuquajturin "Koncertin e Evropës" e deri në vitin 2018, respektivisht deri në

ditët e sotme, kur Federata Ruse ende vazhdon të veprojë nën hijen e pansllavizmit rus, duke mbështetur planet shoviniste serbe ndaj çështjes shqiptare në përgjithësi si dhe ndaj çështjes së Kosovës në veçanti.

Edhe profesor Haxhi Ferati shpreh mendimin se autori Hamz Lladrovci ka arritur të japë kontribut të rëndësishëm

për problemin e parashtruar në librin "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2018)", duke publikuar një studim të thellësishëm të politikës, të gjeopolitikës dhe të diplomacisë rusomadhe në raport me shqiptarët dhe çështjen shqiptare për liri, pavarësi dhe bashkim të trojeve të tyre.

**E jashtëzakonshme**

# Qyteti pa dyer

Njerëzit e Shani Shingnapurit ende mbështesin traditën e mosinstalimit të dymve dhe mbajtjen e shtëpive të tyre të hapura për fqinjët dhe për t'i vizituar pelegrinët. Shani Shingnapur është qytet i vogël

prej rreth 200 shtëpive në lagjen Ahmednagar të Maharashtra, Indi, ku shumica e pelegrinëve vijnë për t'i bërë lutjet e tyre tek zoti Hindu, zoti Shani. Fshatarët refuzojnë t'i mbajnë gjërat e vlefshme të



mbyllura në çelës pasi besimi i tyre në Zotin Shani mbetet absolut.

**FOTO E DITES**



Melania Trump me veshje 4 000 dollarë dhe me taka duke mbjellë pemë

**E rrallë**

## Hëngri peshk të gjallë, 71-vjeçari humb dorën

Një burrë 71-vjeçar nga Koreja e Jugut 12 orë pasi hëngri një peshk, dora e tij e majtë u fry si top golfi dhe u bë shumë e dhimbshme për të. Atij iu bë një fluskë e madhe dhe iu nxi dora pasi u shkaktua infeksion bakterial që merret nga ushqimi i detit i papërpunuar. Trajtimi për ta



shëruar dorën doli të jetë i pasuksesshëm dhe fundi ishte i dhimbshëm për të, pasi iu desh ta këpusë dorën.

**BARSOLETA E DITËS**



- Petrit, jam çmendur pas teje
- Mirë, mirë, por rri larg babait tim
- Pse, është i ashpër me vajzat që të vijnë rrotull?
- Jo, por është drejtor i spitalit psikiatrik



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 16:00**

**“INCREDIBLES 2” 3D**

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird




**Në ora 18:20**

**“FUTURE WORLD”**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



**Në ora 20:00**

**“ANT-MAN AND THE WASP” 3D**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



**Në ora 22:00**

**“LOVING PABLO” (R)**

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.


**Regjia:** Fernando León de Aranoa



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

<p><b>DASHI</b> Kritikat e bëra ndaj jush po japin rezultate pozitive në punën tuaj sepse keni marrë me të mirën prej tyre dhe e keni vënë në zbatim.</p>	<p><b>DEMI</b> Keni kuptuar që jeta është e përbërë edhe nga gjëra të tjera përveç punës dhe po u dedikoheni këtyre gjërave tërësisht sot.</p>	<p><b>BINJAKËT</b> Iniciativat që do të ndërmerri sot do t'ju japin shumë zgjidhje personave afër jush. Dikush do t'ju shpreh falënderimet në një mënyrë të ngrohtë.</p>	<p><b>GAFORRJA</b> Një problem konstant që nuk po ju lë të avanconi duhet ta zgjidhni nga rrënjët sepse do të vazhdojë t'ju torturojë për një kohë të gjatë.</p>	<p><b>LUANI</b> Sot keni vënë në dukje një anë të panjohur tuajën dhe mjaft të ndjeshme. Jeni kokëfortë në shumicën e rasteve dhe nuk i tregoni ndjenjat tuaja.</p>	<p><b>VIrgjresha</b> Dikush do të kërkojë sqarime nga ju se përse gjatë kësaj kohe nuk keni shfaqur përkushtimin e duhur. Është diçka momentale që do të sqarohet.</p>
<p><b>PESHORJA</b> Këtë periudhë keni zgjedhur një mënyrë kontradiktore për të qenë në vëmendje, vetëm nëpërmjet heshtjes tuaj dhe injorimit të personave të caktuar.</p>	<p><b>AKREPI</b> Keni bërë ç'është e mundur për të sqaruar gjërat me një person të caktuar, por përsëri ju kanë keqkuptuar.</p>	<p><b>SHIGJETARI</b> Sot mund t'ju lindin probleme me familjarët sepse nga punët e tepërta do të harroni disa ngjarje dhe situata që nuk mund të harrohen.</p>	<p><b>BRICJAPI</b> U keni dhënë hapësirën e duhur personave të duhur, por nuk jeni shprehur për këtë gjë. Do të keni mirënjohjen e tyre në të ardhmen e afërt.</p>	<p><b>UJORI</b> Të ecni përpara në karrierën tuaj në këto momente paraqitet mjaft e vështirë. Ka rrethana të caktuara që nuk ju lejojnë të bëni atë që doni.</p>	<p><b>PESHQIT</b> Sot doni të ndryshoni rrugën që keni marrë për të tejkaluar një problem të caktuar. Duhet të merrni dhe mendimin e të tjerëve.</p>

## Lili Reinhart fiton çmimin që Rita Ora e fitoi vjet



**L**ili Reinhart i serisë Riverdale është nderuar me këtë çmim në kategorinë e "Conscious Award", pasi ka punuar në përputhje me vizionin e firmës së modës H & M për një të ardhme më të qëndrueshme

për njerëzit dhe planetin. Çmimi ishte për ta përkujtuar angazhimin e saj ekstrem ndaj të mirës shoqërore dhe fuqizimin e të rinjve për t'i ndjekur gjurmët e saj që është me të vërtetë frymëzuese.

## Papuçet e tij bënë xhiron e botës, reagon për herë të parë Kanye West



**K** ishte reagime të shumta për papuçet që Kanye West veshi ditën e dasmës së mikut të tij më parë këtë muaj. Papuçet u bënë virale për shkak të madhësisë së tyre, pasi ishin sa gjysma e këmbës së këngëtarit. Dhe, për më

tepër, të veshura në një dasmë. Por producenti ka reagu për herë të parë në një postim në "Twitter", ku është shprehur se papuçet e tij nga koleksioni i ardhshëm ishin dizajnuar ta kishin atë madhësi që kishin.



## Dua dhe Harry kurorëzohen si zonja dhe zotëria në 'Bum Bum'

**D**ua Lipa dhe këngëtari britanez Harry Styles u zgjodhën si të famshmit me të pasmet më seksi në Hollywood. Ata u votuan online në kompeticionin 'Bum Bum' në Brazil i cili njihet si kompeticioni ku zgjidhen personat me të pasmet

më seksi në botë. Lipa la mbrapa një të tjerë si Kim Kardashian, rep artisten Nicki Minaj dhe Pippa Middleton, të cilat njihet si femrat më seksi në botë. Ndërsa Harry lë mbrapa futbollistët Cristiano Ronaldo dhe David Beckham.

## Michael Jackson po fiton më shumë pas vdekjes sesa kur ishte gjallë



**M**ichael Jackson po fiton para më shumë pas vdekjes sesa kur ishte gjallë, sipas disa dokumenteve të lëshuara nga gjykatat. Mbreti i popit, i cili vdiq në vitin 2009 në moshën 50-vjeçare, raportohet se përballë me borxhe deri në 500 milionë dollarë në kohën e vdek-

jes së tij. Dokumentet tregojnë se ekzekutuesit e pasurisë së tij kanë hequr shumicën e pretendimeve të kreditorëve, por disa borxhe kanë mbetur ende. Megjithatë, siç raportohet nga "The Mirror", pasuria e Jackson arriti në 74 milionë dollarë në vitin 2015.

# Recension për dy librat e poetit Fehmi Pireva



Salihë SALIHU - PhD dhe veprimtare

Poeti Fehmi Pireva ka botuar dy libra me poezi të cilat janë të shkruara në gjini lirike, por tematikat e këtyre poezive shtrihen që nga e thjeshta, e dukshmja e prekshmja deri te lartësitë e reve që bashkohen në shkronja e hyjnë në poezi - pra edhe retë në lartësi janë burim frymëzim për vetë autorin. Mjaft impresionuese apo jo?

Çfarë të them për poezitë e autorit?

Në poezitë për fëmijë në librin "Piktori i qiellit" poeti hynë në botën e fëmijëve dhe flet me fjalë të mbushura me ngjyra e me figura specifike, si hëna mysafir, por përmes hënës poeti u sjell fëmijëve edhe trojet shqiptare tok të mbledhura rreth një abetare. Pra, poeti i brumosur me atdhedashuri përpiket që

talentin e vet letrar ta shkrijë në tematika të vendit të tij, t'i zbukurojë trojet e veta me estetikë letrare.

Me ekspresionizim e tij gjuhësor poeti bën përpjekje ta zgjojë kureshtjen e fëmijëve për vendet kah flitet gjuha shqipe. Me të njëjtin stil artistik janë poezi "Pak Det nga Durrësi, Kush i Mbanë Retë", ku përmes poezisë zogu nga Shkodra sillet në Prishtinë.

Në disa raste gjatë leximit të poezive të poetit Fehmi Pireva na kujton poezitë e plejadës së poetëve bashkëkohorë si Rexhep Hoxha, me poezinë "Zilja e shkollës po na fton" e që te Fehmi Pireva kemi poezinë "Porosia për shtator". Gjithashtu, ngjashëm sikurse Rifat Kukaj që i ndërthen figurat e larmishme për ta qëndisur vargun e tij me gjithë bukuritë natyrore autoktone, edhe Fehmi Pireva nxjerrë në pah këtë talent të të shprehurit pothuajse në të gjitha poezitë, por si ilustrim për këtë është poezia "Lulet e Malit". Kështu që lirshëm mund të konstatoj se në shumë poezi në librin për fëmijë shfaqet flora e fauna të përpunuar e të ngjyrosura në vargjet poetike të poetit

Pireva.

Në librin për të rritur "Dashuri e qelqtë" lexuesi gjen jo vetëm përplasjen e kohëve, por edhe përplasjen e ndjenjave që influencohen nga ndikimi i teknologjisë në botën postmoderne. Derisa postmodernizmi si perspektivë e re tenton të shkatërojë gjithçka që është tradicionale, të kundërtën e bën poeti Pireva, duke shprehur këmbëngulësinë për ruajtjen e vlerave bashkëkohore tradicionale Me këtë ndjenjë poeti paraqitet në poezi herë si nostalgjik e herë fanatik i dashurisë së çlirët. Poeti me fanatizëm dëshiron ta mbrojë dashurinë duke i refuzuar edhe përfitimet e teknologjisë kur me mllëf thotë: takimet i kemi të qelqta, ç'po ndodh me ne vallë? Në off do ta shpie telefonin, Ty dua të të shoh të gjallë!

Pra, cilësinë misterioze të njerëzve, dridhjen e ndjenjave të dashurisë poeti kërkon t'i ruajë e begatojë në formën e tradicionales bashkëkohore, që dashuria të ruhet e mirëmbahet me rrënjë tradicionale e jo me teknologji, herë off e herë on në stilin postmodern.

Pra, poeti përmes poezive,

përveçse i shpreh vështrimet për dukuri dhe ngjarje të ndryshme e figura të ndritshme të popullit tonë, dëshiron t'i ndajë edhe ndjenjat përmes një gjuhë artistike poetike - pra, me zhanër më të vjetër letrar. Metoda e tij në të shkruar është një organizim strukturor i vargjeve që ndihet dukshëm estetika e të shkruarit, (saqë vetëm imagjinata e poetit mund ta marrë hënën e ta bëjë konsumator në sallonin e kozmetikës apo të njëjtën figurë, pra hënën ta shndërron në postier, me porosinë që të dërgoj një abetare në Preshevë).

Tematikë tjetër që do ta veçojë poetin nga poetët e tjerë është konfiguracioni i heronjve. Poeti në vargjet e veta ka ndërthurur edhe vuajtjet e brezave ku në mënyrë të dhimbshme thotë: Luftërat nuk i pamë veç në filma, por heronjtë i ringjallëm përsëri. Dhe në poezinë për Zahir Pajazitin shkruan: "Ta vrasësh atë në qytet, në mal do ta gjeni përsëri".

Poeti me trishtim nga një parandjenjë frike për humbje të figurës më eminente dhe me vlerë historike që do të vakuon shpirtëror, shpreh brengën: Aty ku nuk është Adem Demaçi,

ÇFARË mund të thotë, vallë poeti?

Pra autori me gjuhën e shpirtit dhe forcën e fjalës na dhuron poezi të këndshme e me plot gjallëri, me kuptim domethënëse e ndonjëherë edhe me mesazhe të qarta si tek poezitë e fëmijëve ashtu edhe poezitë e të rriturve si, p. sh., në poezinë ku i bën thirrje Brukselit që fëmijët e Kosovës të mos kenë viza. Mesazh tjetër gjejmë edhe te poezitë për të rritur ku, siç duket, poeti është i pakënaqur me rrjedhën e zhvillimeve shoqërore dhe shpreh dëshirën e tij për një zhvillim më dinamik, por në mënyrë artistike thotë, mes të tjerash: nuk na duhen më rënkimet, të mos humbë orë e historisë! E zëri këmbues, shpejto, shpejto vrullin, Atdhe!

Krejt në fund mund të them se këto janë librat e poetit i cili me vargjet e tij po dëshmon se ka të gjitha veglat për një rrugëtim jetësor në botën e shkrimit letrar, me të cilën do ta nderojë veten, familjen, Kosovën, në veçanti Lupçin e poshtëm të bacë Adem Demaçit, mbi të gjitha do ta pasurojë letërsinë shqiptare.

Urime e suksese poet, Fehmi Pireva!

## Ali Podrimja: Për kë shkruajmë?

### Ditëlindja e poetit

Në një qytet të Bavarisë, rastësisht më ra në dorë një gazetë e Zagrebit. Duke e shfletuar, hasë një tekst të mikut tim Mirko Kovaç. Me kënaqësi fillova ta lexoj. Vazhdimi ishte dramatik. Plotë gërçe. Ajo që e thoshte shkrimtari i nderuar serb, nuk dëshiroja të ishte e vërtetë. Ishte diçka monstruoze. Diku në Bosnje, në qytetin Foça, kryesisht i banuar me myslimanë, jeta kishte marrë tatëpjetën. Iracionalja mbisundonte arsyen. E kuptoja revoltën e mikut tim.

Por nuk mund ta merrja me mend se njeriu ishte shndërruar në një gjësend pa vlerë; se në mbarim të shekullit XX urrejtja ndërnacionale ishte thjesht instinkt dhe Evropa spektatore në një teatër të absurdit. Sipas shkrimtarit të nderuar, një farë Vojislav Maksimoviq, profesor serb i Universitetit të Sarajevës, rrugëve të përgjakura të Foçës qenka parë duke luajtur futboll me koka të myslimanëve të masakruar.

Nga ato viktime disa, ndoshta, kanë mundur të jenë edhe studentë të tij, të cilët atje buzë Milackës piktoreske, kanë përcjellë ligjëratat e tij mbi të bukurën në art. Por Vojislavi kishte harruar se ishte profesor i Universiteti, që merrej herë pas here edhe me

mjeshtërinë e shkrimit. Ai ishte shndërruar në një fantom dhe me gradën e majorit ushtarak kishte marrë pjesë në vrasje të shumta dhe pastrime etnike.

Rrënimi i Vukovarit, i Mostarit, i Dubrovnikut, i Sarajevës dhe i shumë fshatrave e qyteteve të tjera më pak të njohura flitnin bindshëm se nuk ishte fjala për psikoetikën e individit. Paranoja, pra, nga dita më ditë zbulonte fytyrën e vet të shëmtuar jo vetëm në shkrime bulevardeske, por edhe në etnosin, ideologjinë dhe filozofinë e një populli që i afrohej katastrofës. Në krye të asaj të keqeje qëndronin shkrimtarë, gjysmëshkrimtarë, intelektualë, kuaziintelektualë, politikanë të dyshimtë e kriminelë në zë, që i gjurmonte policia ndërkombëtare. Me programe nacionaliste dhe elaborate fashistoide mbusheshin bibliotekat, ose krijoheshin të reja, – sipas skenarëve.

### Eklipsi

E kë nuk e shqetëson kjo? Në vetëdijen e krijuesit kishte ndodhur një eklips i tmerrshëm, humaniteti as dinjteti nuk ekzistonte më. Sipas kokave nacionaliste një "popull qiellor" nuk mund të gabojë. Atij i lejohet çdo gjë. Edhe krimi. Toka serbe shpallëshin brenda nate edhe ato vende ku një qorr apo topall i sojt



të tyre kishte kaluar ndonjëherë. Ose, ekspeditat ndëshkuese shpejtonin të shlyenin çdo gjurmë nga trashëgimia kulturore e identitetit të të tjerëve në trojet e pushtuara me dhunë. Nga një filozofi primitive nuk mund të lindte diçka njerëzore, pos një krijesë qiç, pikëlluese, pa vlerë – me një mjerim të thellë shpirtëror.

Sepse, dihet, nacionalizmi është qiç. Kështu thoshte dhe Danilo Kishi. Por mu nacionalizmi na u bë ushqim kryesor për mediokër, që shtoheshin rreth tryezës nacionale. Ata krijues të paktë, të cilët kishin guxim intelektual t'i kundërvihen kësaj paranoje kolektive, shpallëshin tradhtarë të interesave kombëtare; botuesit ua mbyllnin dyert, ose detyroheshin ta marrin udhën e ekzilit. Guximi i

Mirko Kovaçit ma kujtonte fatin edhe të një poeti serb i cili, duke parë në ekranin TV se ç'po ndodhte me fëmijët shqiptarë, në demonstrata paqësore dhe masakra të policisë serbe kishte qarë për shkak të turpit dhe mjerimit të popullit të vet.

Dorë pas dore, pas sa ditësh, më kishte arritur një poezi e tij për fëmijët, që kishin rënë nga breshëri i plumbave dumdum. E kishte shkruar atë natë të kobshme. "Ti mund ta botosh. Unë do të të jem mirënjohës tërë jetën se më ndihmon ta pështyj në fytyrë nacionalizmin e popullit tim", kaq më kishte thënë në telefon, por edhe në një letër që kisha marrë pas një gjysmë viti udhe. Poeti që e thoshte këtë, e kishte kundërshtuar regjimin totalitar një gjysmë

jete dhe poezia për fëmijët shqiptarë, as mllëfi i tij nuk ishte një gjest. Ai besonte në vlerën dhe lirinë e njeriut, para se gjithash, ai mbronte etikën e shkrimtarit në një kohë të ligë kur euforia nacionaliste u bë metaforë e së keqës, eklips, më e fortë se fjala e tij prej humanisti.

### Në mes nacionalizmit e kombëtares: udha e krimeve

Devavlimin shpirtëror të krijuesit, që e mundonte jo vetëm Mirko Kovaçin, e theksonte edhe më rëndë disidenti dhe bard malazias, Jevrem Bërkoviç, në një tubim ndërkombëtar të shkrimtarëve të mbajtur në Bled. Por tmerrri e agresiviteti i një diktature nacionaliste-staliniste ishte diçka e rëndomtë për ne shqiptarët. Vrasjet e eksodet, ndjekjet dhe tmerrin e bardhë ne e kishim përjetuar me dhjetra herë gjatë historisë sonë mijëvjeçare. Nëse Evropës nuk i kujtohet tragjedia e Çamërisë, pastaj ajo e Toplicës; nëse Evropa u mbyll në hipokriziminë e vet edhe pas vrasjeve e eksodeve të mëdha të viteve '50, '60, '80 dhe '90, duke konstatuar vetëm se atje në Ballkan po ndodh diçka e tmerrshme, kujtesa

(gazeta-Shqip.com)



**EURO GLASS**  
SAINT-OBISAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SHKENDEIJA - ROSENBORG

2

BURNLEY - OLYMPIAKOS

1

AEK LARNACA - TRECIN

1

## UEFA mbështet financiarisht ndërtimin e tri fushave në Obiliq

"Ky projekt është një prej projekteve më të rëndësishëm në infrastrukturën sportive. Të gjitha investimet do të bëhen në bashkëpunim të MKRS-së dhe FFK-së. Është një model i ri i bashkëpunimit për vitin 2018-2019 për infrastrukturën sportive, që nga anëtarësimi i sportit tonë në FIFA dhe UEFA kërkon", ka thënë ministri Kujtim Gashi



PRISHTINË, 29 GUSHT - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata e Futbollit e Kosovës kanë nënshkruar të mërkurën një memorandum bashkëpunimi që FFK-së t'i kalohen në shfrytëzim dy parcela në Komunën e Obiliqit në hapësirë totale prej 102,817 m<sup>2</sup>. Shfrytëzimi i këtyre parcelave do t'i jepet FFK-së me qëllim të investimit në një stadium që do të ndërtohet në këtë hapësirë, ku kjo e fundit do të investojë tre milionë euro. Në kuadër të këtij projekti kapital në fushën e infrastrukturës fizike sportive do të ndërtohen stadiumi kryesor, tribunat, ndërtesa e qendrës dhe fushat ndihmëse.

Në bazë të këtij memorandumit, i cili ka për qëllim zhvillimin dhe masivizimin e sportit, ngritjes së kapaciteteve dhe investimeve në infrastrukturën sportive, parashihet që pas përfundimit të projektit të punësohen punëtorë nga Komuna e Obiliqit. FFK-ja do të mirëmbajë dhe

menaxhojë tërë kompleksin dhe do t'i koordinojë aktivitetet dhe manifestimet sportive dhe pa kompensim do të lejojë që të tillat të zhvillohen në këtë kompleks. Ministri Kujtim Gashi u shpreh se memorandumit që po nënshkruajnë me FFK-në të dyja institucionet do të investojnë në tri fusha ndihmëse në Obiliq.

Ministri shpjegoi se mjetet financiare të cilat do të shfrytëzohen për realizimin e këtij projekti janë nga buxheti i UEFA-së dhe procesin e investimeve do ta përfundojë FFK-ja, kurse Ministria e Sportit ka siguruar këto parcela nga Komuna e Obiliqit. "Ky është një prej projekteve më të rëndësishëm në infrastrukturën sportive për investime në bashkëpunim me MKRS-në dhe FFK-në. Është një model i ri i bashkëpunimit për vitin 2018-2019 në infrastrukturën sportive, që nga anëtarësimi i sportit tonë në FIFA dhe UEFA", ka thënë ministri Gashi. "Ne po krijomë mundësi të reja në infrastrukt-

urën sportive me qëllim që t'i plotësojmë kushtet e klubeve tona. Infrastruktura sportive mungon. Shumë klube nuk kanë ku t'i zhvillojnë përgatitjet për lojëra. Ky është projekt i qëlluar dhe meritë e FFK-së që ka arritur t'i sigurojë mjetet financiare nga UEFA", ka shtuar ai. Ndërkaq, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka deklaruar: "Ky është një prej projekteve të cilat do t'i realizojmë. Kemi filluar me projektet e 12 stadiumeve për 12 ekipe. Kemi përfunduar stadiumin 'Fadil Vokrri', i cili, falë angazhimit të ministrit dhe Ministrisë, ka përfunduar dhe është stadium i cili do të pranohet për ndeshjet e kategorisë katër, po ashtu së shpejti do të fillojë projekti edhe për stadiumin 'Adem Jashari' i cili do të bëhet stadiumi i kategorisë katër. Do të kemi edhe projekte të reja të cilat do të financohen nga Ministria e Sportit si Stadiumi Kombëtar, stadiumi i Prizrenit, i Gjilanit dhe në të gjitha qytetet".

### SHKURT

#### Lushtaku: Ndaj Prishtinës për rezultat pozitiv

Trajneri i KF Drenica, Tahir Lushtaku, ka bërë me dije se skuadra nga Skenderaj synon rezultat pozitiv ndaj Prishtinës në ndeshjen e tretë të këtij edicioni që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. "Do të jetë një ndeshje e vështirë, duke e ditur forcën që ka Prishtina si dhe faktin që luajmë si mysafirë. Do të jemi maksimalisht të përgatitur për këtë ndeshje dhe do të mundohemi të marrim rezultat pozitiv. Duhet të jemi realë se Prishtina ka një super ekip, të përforcuar mjaft mirë dhe është skuadra numër një në vend", ka thënë Lushtaku.

#### Greza kryen testet mjekësore te Rangersi

Eros Greza do të jetë lojtar i skuadrës së Rangersit, ashtu sikurse që raportoi "Epoka e re" të hënën. Zyrtarizimi i sulmuesit kuqezi në skuadrën skoceze është çështje orësh, kurse mediet vendëse raportojnë se ai tashmë ka kryer edhe testet mjekësore. Skuadra e Rangersit drejtohet nga legjenda e Liverpoolit, Steven Gerrard.

#### Ibrahimi: Jemi gati për ta shkruar historinë

Besart Ibraimi ka folur para ndeshjes kundër Rosenborgut, e cila zhvillohet të enjten në kuadër të Evropë Ligës. Shkëndija pësoi humbje në ndeshjen e parë 3-1, por Ibraimi beson se skuadra kuqezi mund të kualifikohet tutje. "Dua të potencoj se jemi për herë të tretë në 'play-off' të Evropë Ligës dhe kjo paraqet sukses të madh për ne. Tani sigurisht se duam të bëjmë histori të re dhe të hyjmë në grupe, por pa i krijuar presion vetes. Kundërshtari vjen me llogaritë e veta. Kemi rezultat negativ nga ndeshja e parë, por premtojmë maksimumin për ta tentuar përmbyshjen dhe për të bërë këtë na duhet edhe mbështetja e publikut", ka thënë Ibraimi.

## Kosova, dy ndeshje miqësore me Maqedoninë

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Përfaqësuesja A e femrave është nisur për Maqedoni, ku do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore me kombëtaren e Maqedonisë. Ndeshjet do të zhvillohen më 30 shtator dhe më 2 tetor në Shkup. "Do ta shfrytëzojmë

rastin të shohim nga afër performancën e prurjeve të reja. Është shumë e rëndësishme që nuk kemi asnjë refuzim të futbollisteve nga jashtë, që flet se ekipi kombëtar i Kosovës po bëhet gjithnjë e më joshës. Tashmë pas pranimit në UEFA dhe FIFA

edhe qasja në FFK ka ndryshuar shumë sa i përket futbollit të femrave, ku kemi angazhim të jashtëzakonshëm. Shpresoj të marrim më të mirën nga këto dy ndeshje me Maqedoninë", ka thënë përzgjedhësja Afërditë Fazlija.



## Hamiltoni: Besoj te forca e Mercedesit

LONDËR, 29 GUSHT - Lewis Hamiltoni e ka lënë pas krahëve zhgënjimin në garën e Belgjikës, ku u rendit i dytë, edhe pse e nisi atë nga "pole position". Pas polemikave që pati me drejtuesit me FIA-s, për shprehjen e tij se "Ferrari i Vettelit e parakaloi

me një truk special", piloti britanik ka lënë pas krahëve garën e Spa dhe mendon për sfidën e radhës, garën e Italisë, që këtë të diel zhvillohet në pistën e Monzas. "Në këto momente Ferrari është më i shpejtë se ne dhe po dominon. Unë nuk doja

të thosha se Ferrari po përdor diçka ilegale, por vetëm që ka diçka që e ndihmon për të pasur një paraqitje më të mirë se Mercedesi", ka thënë Hamiltoni, duke shtuar: "Nuk jam i shqetësuar për atë garë. Duhet të përfitojmë nga

mundësitë që na jep makina jonë dhe ta marrim maksimumin në pistë. Vetëm duke vepruar kështu mund ta fitojmë titullin kampion. Unë besoj te Mercedesi, por garat e ardhshme do të jenë indikator i mirë i forcës së makinës sonë".



## Schweinsteigeri i jep lamtumirën futbollit



MUNCHEN, 29 GUSHT - Mbrëmja e së martës ishte sa speciale, unike, po aq magjike. Bastian Schweinsteiger i dha lamtumirën përfundimtare futbollit të luajtur, në një ndeshje të zhvilluar në "Allianz Arena", fortesa e Bayern Munchenit të tij me të cilin ka fituar gjithçka në karrierë. Në fushë u sfiduan bavarezët nga njëri

krah dhe amerikanët e Chicago Fire, nga ana tjetër, ekipi i fundit ku është aktivizuar mesfushori gjerman. Por, ndryshe nga lamtumirat e tjera të futbollit, kjo ndeshje pati diçka të veçantë: një pjesë Bastian e luajti për amerikanët, e pjesën tjetër me fanellën e gjigantëve të Bundesligës, duke shënuar edhe golin e katërt të

ndeshjes që u mbyll me rezultatin 4-0. "Ishte një mbrëmje e paharueshme. Në fund të fundit, jeta është e mbushur me kujtime dhe jam i lumtur që kam përjetuar këto çaste. Fakti që munda ta ndaja edhe me tifozët e Bayernit e ka bërë këtë mbrëmje edhe më të bukur", ka thënë Schweinsteigeri.

## Mane: Duam titullin dhe Ligën e Kampionëve

LIVERPOOL, 29 GUSHT - Sadio Mane ka zbuluar objektivat sezonale të Liverpoolit. Gjithashtu, senegalezi flet edhe për marrëdhënien me trajnerin Jurgen Klopp dhe "rivalitetin" me Salahin. Në një intervistë për "Marca", ai shprehet se ekipi do ta bëjë të pamundurën ta fitojë kampionatin, që mungon që prej 1990 te Liverpooli. "Është sfidë e madhe. Ky është dhe shkaku se pse klubi ka firmosur me lojtarë të mëdhenj. Duam të bëjmë diçka të veçantë pa presion të tepërt. Të gjithë flasin për ne, por duhet t'i marrim ndeshjet me radhë. Është ende herët për të folur për trofe, sepse jemi në fillim të sezonit. Objektivi ynë është titulli dhe Liga e Kampionëve", ka thënë Mane. "Kloppi është një person që e dashuron atë që bën. Ai të motivon dhe përmirëson në çdo moment. Krijon një lidhje të veçantë me futbolistët dhe kjo është një shtysë e madhe. Jam rritur shumë në drejtimin e tij dhe jam i lumtur që e kam trajner", ka shtuar Mane, i cili flet edhe për idhullin e tij në futboll: "Idhulli im ka



qenë Ronaldinho dhe jam frymëzuar nga ai. Për momentin nuk kam ndonjë lojtar të veçantë që e admiroj, por janë një grup futbollistësh që unë i ndjek për t'u përmirësuar". Ndërsa në lidhje me Salahin, mane ka thënë se

është më i shpejtë se sulmuesi egjiptian. "Unë jam më i shpejtë se ai. Nëse do të garonim do të fitoja unë. Në distancë të shkurtër ai është më i shpejtë, por në 100 apo 200 metra fitoj unë", ka deklaruar Mane.

### SHKURT

#### Strakosha në "radar" të Interit

Portieri i Lazios, Thomas Strakosha, ka përfunduar në "radar" të Interit. Forma jo e mirë e Samir Handanoviçit ka bërë që drejtuesit e klubit të Interit të mendojnë për transferimin e një portieri të ri. Bëhet fjalë për shqiptarin Thmoas Strakosha, por në listën e skuadrës italiane është edhe Alphonse Areola i PSG-së.

#### Ronaldo refuzon ftesën e Portugalisë

Cristiano Ronaldo nuk do të jetë i gatshëm për ndeshjet që kombëtarja e tij do të zhvillojë ndaj Kroacisë dhe Italisë. Kështu portugezi nuk do ta ketë mundësinë të përballet në Ligën e Kombeve kundër shokëve të vet të rinj të skuadrës, ndeshje e programuar për datën 10 shtator. Ai ka preferuar të qëndrojë në Torino për t'u stërvitur për Ligën e Kampionëve. 33-vjeçari po krijon volum loje në kampionatin italian, por nuk ka gjetur ende rrugën e rrjetës në dyndeshjet e para me fanellën bardhezi. Refuzimi i kombëtares është një lajm i mirë për tifozët e Juventusit, por nuk dihet si do ta presin bashkëkombësit e tij.

#### Henry: Me Guardiolan, mësova se si të luaj sërish futboll

Thierry Henry në moshën 30-vjeçare u transferua nga Arsenalit në Barcelonë. Ai ka thënë se edhe në atë moshë ka mësuar nga trajneri i atëhershëm i Barçës, Pep Guardiola. "Unë mësova si të luaj futboll sërish në moshën 30-vjeçare. Ai kujdeset për gjithçka, për çdo detaj, se çfarë duhet të bëjë lojtari kur kundërshtari ka topin, kur shoku juaj i skuadrës ka topin, gjithçka, gjithçka, thjesht i jashtëzakonshëm", ka thënë Henry për "Sky Sports".

#### Juve nuk e lëshon Mandzukiqin

Skuadra e Juventusit planifikon ta mbajë sulmuesin Mario Mandzukiq. E përditshmja sportive italiane "Tuttosport" shkruan se "Bianconerët" kanë bërë gati kontratë të re për sulmuesin nga Kroacia. Mandzukiq është aktualisht i lidhur deri në vitin 2020 me rrogë prej 5 milionë eurosh në sezon, por me kontratën e re ai do të ketë rritje të pagës dhe mund të pensionohet te skuadra nga Torino.

#### Kariusi prezantohet te Beshiktashi

Portieri gjerman Loris Karius është prezantuar te skuadra e Beshiktashit. Ai nuk ka pranuar të jetë portier i dytë i Liverpoolit dhe ka zgjedhur të krijojë karrierë në një ambient të ri. "Kam qenë pjesë e ndeshjeve para sezonale të Liverpoolit. Kam stërvitur gjatë ditëve të fundit në palestër te 'The Reds' vetëm për të mos pësuar ndonjë lëndim të rëndë. Jam i gatshëm dhe nëse më jep rast trajneri Senol Gunes, do të luaj që në ndeshjen e ardhshme", ka thënë Karius, i cili ka treguar se Jurgen Klopp kishte kërkuar të qëndronte në Liverpool. "Kam pasur një bisedë të gjatë me Kloppin. Ai deshi të më mbajë, por ia bëra të ditur se jam i vendosur të largohem. Mendoj se kemi arritur një marrëveshje në të mirë të dy palëve", ka shtuar Karius.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite  
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA  
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L - 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës shpall:**

## K O N K U R S

**Titulli i pozitës së punës:** Zyrtar për Shërbime të Punësimit (dy pozita)  
**Vendi:** Zyra e Punësimit - Rahovec; Referenca: RN00003629 (një pozitë)  
**Vendi:** Zyra e Punësimit - Shtërpçë; Referenca: RN00003630 (një pozitë)  
**Institucioni:** Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës  
**Lloji i pozitës:** I karrierës  
**Tipi i Akt Emërimit të punës:** Orar të plotë punë  
**Titulli i mbikëqyrësit:** Udhëheqës i Zyrës së Punësimit  
**Kategoria funksionale:** Niveli Profesional  
**Grada/Koeficienti:** Koeficienti – 6.5  
**Procedura e aplikimit:** I jashtëm

**Qëllimi i vendit të punës:** Bëni vlerësimin e nevojave të të papunësuarve dhe punëkërkuësve dhe siguron këshilla dhe informacione sipas nevojave të tyre për të ndihmuar të gjejnë punë; njëkohësisht ofron këshilla dhe informacione për punëdhënësit që kërkojnë punëtorë ose ndihmë tjetër lidhur me rekrutim dhe bën ndërmjetësimin në punësim.

### Detvat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Identifikon vështirësitë kryesore të të papunësuarit për punësim, interviston dhe regjistron klientët në SIMP.
